



Kosova



Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030







Vizioni për Kosovën





1. Hyrje	5
2. Përgaditja e Planit Kombëtar për Zhvillim 2030	6
2.1. Qasja strategjike	6
2.2. Procesi i hartimit	8
2.3. Koordinimi i procesit	8
3. Analizë e gjendjes aktuale	9
4. Vizioni dhe prioritetet zhvillimore të Kosovës	15
4.1. Vizioni	15
4.2. Shtyllat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030	15

5. Qëllimet zhvillimore 17

	I. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	25
	Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese	26
	Infrastrukturë e cilësisë së lartë, e qëndrueshme dhe e integruar	30
	Mjedis i pastër dhe shfrytëzim më i mirë i burimeve natyrore	33

	II. Zhvillimi i barabartë njerëzor	39
	Punësim i lartë, i dinjitetshëm dhe gjithëpërfshirës	44
	Shëndet dhe mirëqenie e përmirësuar	47
	Kulturë kreative dhe shoqëri aktive	51

	III. Siguria dhe sundimi i ligjit	55
	Gatishmëri e lartë për paqe dhe siguri	56
	Drejtësi efektive	60

	IV. Qeverisja e mirë	65
	Qeveri efektive dhe llogaridhënëse	66
	Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar	69

6. Agjendat horizontale	72
6.1. Agjenda Digjitale e Kosovës	72
6.2. Mundësi të barabarta	73
6.3. Agjenda e gjelbër	74
6.4. Migrimi dhe Diaspora	75
7. Financimi i SKZH 2030	77
8. Zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi	79
9. Shtojcat	82
A. Lista e treguesve për të cilët mungojnë të dhëna	82
B. Lista e dokumenteve strategjike që duhet mbajtur dhe zhvilluar	88
C. Agjendat horizontale dhe ndërlidhja me dokumentet strategjike	94

Shkurtesat¹

AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
COFOG	Klasifikimi i Sektorëve sipas Funksioneve të Qeverisë
DKA	Drejtoritë Komunale të Arsimit
ERA	Agjenda për Reforma Evropiane
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GHG	Gazrat serrë
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GDPS	Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik
GPT	Grupet e Punës Tematike
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IP	Inspektorati i Punës
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KE	Komisioni Evropian
KPS	Komisioni për Planifikim Strategjik
KPMS	Korniza për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MICS	Anketa e Treguesve të Shumëfishtë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SHPP	Shërbimet Publike të Punësimit
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
OB	Organizatata Buxhetore
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OS	Objektiva Strategjike
UNDCO	Zyra e Koordinatorës të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNDP	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Emergjencave për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
VShB	Vlera e Shtuar Bruto
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

¹ Në rastet kur shkurtesa është më e njohur në gjuhën angleze se sa në gjuhën shqipe, do të përdoret shkurtesa në gjuhën angleze.

1. Hyrje

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka bërë përparim të mirë në ndërtimin e institucioneve dhe zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor. Pozita gjeografike dhe përparësitë krahasimore të saj, e bëjnë Kosovën një vend të lakmueshëm për të bërë biznes. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm mbetet një nga sfidat kryesore të vendit. Krizat e ndryshme, si kriza pandemike, kriza energjetike dhe së fundi lufta në Ukrainë, në njërën anë e kanë testuar aftësinë dhe kapacitetin për veprim të Kosovës në mjedis të paparashikuar, me mjete e mundësi të kufizuara, ndërsa në anën tjetër e kanë vënë pah nevojën për planifikim afatgjatë dhe investime strategjike. Për këtë qëllim, vizioni për Kosovën e vitit 2030, e vendos në qendër zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e standardit të jetesës, efektivitetin e institucioneve dhe anëtarësimin në strukturat Evro-atlantike.

Plani Kombëtar i Zhvillimit synon zhvillimin e një platforme që kombinon nevojën për një vizion afatgjatë të vendit me aktivitete konkrete për të sjellë ndryshime të dëshirueshme. Prandaj, PKZH përbëhet nga dy pjesë: një vizion afatgjatë i Kosovës, që përcakton qëllimet zhvillimore dhe strategjike deri në vitin 2030 i quajtur Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 (SKZH 2030), dhe pjesa e dytë që përcakton masata strategjike tregues dhe veprime specifike për tre vitet e ardhshme. Kjo perspektivë trevjeçare përkon me horizontin e planifikimit buxhetor afatmesëm, duke siguruar që ajo që synohet të zbatohet të ketë mbështetjen e burimeve financiare. Kërkon konkretizimin dhe priorizimin e reformave dhe investimeve që në SKZH 2030 paraqiten si drejtime përmes qëllimeve zhvillimore, qëllimeve strategjike dhe treguesve të ndikimit, por jo si aktivitete. SKZH 2030 përmban një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes sociale dhe ekonomike dhe përcakton nevojat e sfidat që duhet të adresohen tani për të bërë ndryshim deri në vitin 2030. Zbatimi i vizionit duhet të kontribuoj në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim të vendit në strukturat e Euro-Atlantike, dhe njëkohësisht përkushtimin për zbatimin dhe integrimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ). PKZH merr kuadrin e qëllimeve dhe treguesve nga SKZH 2030 dhe e plotëson atë me masa dhe aktivitete politikash në një perspektivë afatshkurtër dhe afatmesme (1-3 vjet).

PKZH është zhvilluar në dy faza, duke reflektuar natyrën e saj të dyfishtë të kornizës strategjike afatgjatë dhe relativisht të qëndrueshme deri në vitin 2030 (pjesa e SKZH) dhe një perspektivë më dinamike, trevjeçare që rrjedh nga SKZH, por edhe prioritete të tjera të qeverisë qoftë të lidhura në axhendën e politikës së brendshme ose të integritimit në BE.

PKZH është hartuar duke ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, që përfshinë të gjithë sektorët e politikave publike dhe agjendat horizontale relevante, të mbledhura rreth katër grupe të temave, shtyllat e zhvillimit, të cilat përmbledhin aspektet dhe fushat kryesore për zhvillimin e vendit:

- I. Rritja e qëndrueshme ekonomike;
- II. Zhvillimi i barabartë njerëzor;
- III. Siguria dhe sundimi i ligjit; dhe
- IV. Qeverisja e mirë.

Pjesa e dytë e PKZH-së, u zhvillua me përfshirjen e të gjitha ministrive dhe u organizua rreth të njëjtës strukturë prej katër shtyllash, nën të cilat ministritë bashkëpunuan për të hartuar masa dhe aktivitete politike për adresimin e synimeve zhvillimore dhe objektivave strategjike.

2. Përgaditja e Planit Kombëtar për Zhvillim 2030

2.1. Qasja strategjike


Qasja për përgatitjen e PKZH-së mbështetet në konceptin e sistemit të planifikimit të zhvilluar në Kornizën për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik (KPMS). KPMS përcakton elementet kryesore të reformës së sistemit të planifikimit. Përcaktimi i hierarkisë së qëllimeve dhe treguesve të performancës dhe përcaktimi i sektorëve, përveç monitorimit dhe raportimit më të mirë, mundëson një qasje më konsistente ndaj menaxhimit të politikave publike dhe shpërndarjes së burimeve në nivel strategjik.

Për këtë qëllim, PKZH mbledh të dhëna nga burime të ndryshme, si prioritetet politike të qeverisë, axhenda e integritimit në BE dhe strategjitë sektoriale dhe ofron bazën për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), e cila mundëson ndërlidhjen e sektorëve, priorizimin e nismave të politikave (masat e politikave) dhe kuadrin buxhetor. PZH do të shkojë edhe më thellë se kaq duke përfshirë edhe aktivitete në secilën prej masave të politikës. Ndër të tjera, PKZ-ja përcakton dallimin midis objektivave afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra, të cilat zbërthehen nga dokumente të tjera strategjike, të renditura dhe shpjeguara në ilustrimin e mëposhtëm.

Figura 1. Korniza e planifikimit strategjik



Thjeshtimi i kornizës strategjike është propozuar duke u bazuar në rishikimin e sektorëve të politikave publike dhe në analizën e të gjitha dokumenteve strategjike ekzistuese. Ky propozim është përmbledhur në Shtojcën B, e shoqëruar me përcaktimin e agjendave horizontale të përmbledhura në Kapitullin 6 dhe Shtojcën C.



PKZH 2030 përfshin qëllimet në një mënyrë hierarkike ku qëllimet e zhvillimit dhe synimet strategjike përcaktohen në SKZH 2030 si pjesë e PKZH-së dhe qëllimet strategjike udhëzojnë ministratë në zhvillimin e strategjive të tyre sektoriale. Si SKZH 2030 ashtu edhe strategjitë sektoriale janë një pikënisje për arritjen e masave dhe aktiviteteve strategjike në pjesën e 'planit operacional' të PKZH-së (shih figurën më lart). Kjo qasje synon të sigurojë konsistencën e planifikimit strategjik midis dokumenteve të ndryshme dhe promovimin e të menduarit strategjik dhe analitik në administratën publike.

Siç u theksua më lartë, SKZH 2030 përbëhet nga katër shtylla, të cilat përmbledhin aspektet dhe fushat kryesore për zhvillimin e vendit dhe përmbajnë qëllimet zhvillimore dhe strategjike, sipas shpjegimeve të mëposhtme:

- **Shtyllat** ofrojnë drejtimin strategjik, ku përmbledhen aspektet dhe fushat kryesore që përcaktojnë drejtimin e zhvillimit të vendit, që grupojnë dhe sheshojnë qëllimet zhvillimore.
- **Qëllimet zhvillimore** burojnë nga sfidat kryesore për zhvillim, të identifikuar gjatë hartimit të SKZH 2030, nëpërmjet të cilave shprehet synimi i përgjithshëm i intervenimeve në aspekte të caktuara sociale dhe ekonomike. Përcaktimi i tyre nuk është i ndërlidhur me fushëveprimin e vetëm një sektori apo me përgjegjësinë e vetëm një institucioni, pasi që janë të shoqëruara me tregues të ndikimit që mbulojnë procese zingjirore të shumë sektorëve dhe politikave publike dhe që pasqyrojnë ndikimin e ndërhyrjeve të planifikuara.
- **Qëllimet strategjike** janë zëbritimi i qëllimeve zhvillimore që përcaktojnë kahjen e sektorëve përkatës. Përcaktimi i tyre mund të ndërlidhet me fushëveprimin e vetëm një sektori apo me përgjegjësinë e vetëm një institucione, pasi që janë të shoqëruara me tregues të ndikimit për matjen e efekteve afatgjata të ndërhyrjeve të planifikuara.
- **Masat strategjike** janë mënyra të realizimit të qëllimeve strategjike dhe përfaqësojnë perspektivë afatmesme deri në atë afatgjatë. Ato ndiqen nga një ministri e veçantë dhe janë të pajisura me tregues të rezultateve së bashku me vlerat bazë dhe objektivin. Masat strategjike i lënë vendin aktiviteteve që nevojiten për t'i realizuar ato.
- **Aktivitetet** janë komponenti i nivelit më të ulët në hierarkinë e planifikimit dhe ato përfaqësojnë veprimet e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të një mase strategjike. Vetë aktivitetet maten përmes treguesve të prodhimit, të pajisur me atë që duhet të dorëzohet dhe afatin e fundit për një ofrim të tillë. Një ministri përgjegjës për një aktivitet mund ta ndajë më tej në nën-aktivitete, por ky informacion nuk duhet të publikohet.

2.2. Procesi i hartimit

Procesi i hartimit të PZH 2030 u zhvillua në dy faza: përgatitja e SKZH 2030 nga tetori 2020 deri në korrik 2022 dhe përgatitja e pjesës së dytë tetor - dhjetor 2022. Procesi ishte gjithëpërfshirës, me konsultime të vazhdueshme me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal, shoqërinë civile, komunitetin akademik, të rinjtë, grupet vulnerabël, sektorin privat dhe partnerët e zhvillimit. Këtë qasje e ka shoqëruar hartëzimi i të gjitha strategjive sektoriale në fuqi dhe vlerësimi i pavarur i SKZH 2016-2021, që ndonëse për fokus ka shtyllën e kapitalit njerëzor, përmban analizën e procesit dhe disejnimin të SKZH 2016-2021, si tërësi.²

Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë nr.15/34 të datës 7 tetor 2020, dhe Konceptin për hartimin e PKZH-së 2030³, procesi i hartimit të SKZH-së ka kaluar në katër faza kryesore, si më poshtë:

- Përgatitja dhe vendosja e strukturave për hartimin e SKZH 2030 – që përfshinë analizën e sistemit të planifikimit, definimin e sektorëve të politikave publike, hartëzimin e dokumenteve strategjike, vlerësimin e SKZH 2016-21, dhe krijimin e strukturave për hartimin e PKZH 2030
- Definimi i problemeve, sfidave dhe pengesave për zhvillim të vendit – në katë faza është ndërmarrë analiza e sektorëve të politikave përmes metodologjisë SËOT, identifikimi i sfidave zhvillimore dhe shqyrtimi në kuadër të grupeve tematike, dakordimi i listës së sfidave zhvillimore për katër shtyllat dhe setkorët e politikave publike.
- Vendosja e kornizës së planifikimit: shtyllat, qëllimet, objektivat strategjike dhe treguesit. Duke u bazuar në listen e sfidave zhvillimore, identifikimi i qëllimeve dhe objektiveve strategjike dhe të njëjtat janë shqyrtuar nga Komisioni për Planifikim Strategjik dhe grupet tematike. Gjithashtu, gjatë kësaj faze është bërë definimi treguesve për matjen e performancës dhe përcaktimi i caqeve të ndërmjetme (2026) dhe përfundimtare (2030), si dhe ndërlidhja e qëllimeve dhe objektiveve strategjike me OZHQ dhe Agjendën e Integritimit Evropian.
- Konsultimi i qëllimeve zhvillimore dhe strategjike ka përfshirë diskutimin me hisedarë të ndryshëm, si shoqëria civile, academia, sektori privat dhe partnerët zhvillimorë, dhe adresimin e komenteve nga konsultimet publike
- Përgatitja e PO 2023-2025 është bazuar në dokumentet strategjike sektoriale dhe informata të tjera që përcaktojnë orientimin e zbatimit të qëllimeve strategjike. Është udhëhequr nga ZKM dhe ka përfshirë të gjitha ministritë. Janë zhvilluar një sërë seminaresh për të shpjeguar procesin dhe rezultatet e pritshme të tij, si dhe punën që ministritë duhej të ndërmerrnin për të prodhuar rezultatet.

2.3. Koordinimi i procesit

Koordinimi i procesit për hartimin e SKZH 2030 ka ndjekur rregullat dhe udhëzimet e planifikimit strategjike. Strukturat përgjegjëse për hartimin e SKZH 2030, ishin si më poshtë:

- **Komisioni për Planifikim Strategjik (KPS)**, që kryesohet nga Kryeministri dhe është përgjegjës për udhëheqjen e procesit të planifikimit të politikëbërjes strategjike, para vendimmarrjes përfundimtare nga Qeveria. Në këtë proces, KPS ka shqyrtuar dhe dhënë pëlqimin për përcaktimin e prioritetëve zhvillimore, në faza të ndryshme të procesit.

² Vlerësimi i SKZH 2016-2021. Datë: Burimi: <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/06/Vleresimi-i-Shtylles-1-Kapitali-Njere%CC%88zor-te%CC%88-SKZH-2016-2021.pdf>

³ Vendimi dhe koncepti për hartimin e SKZH-së 2030. Burimi: <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/12/Koncepti-per-hartimin-e-Strategjise-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

- **Grupet tematike** për katër shtyllat, të përbëra nga hisedarë dhe ekspertë të ndryshëm të institucioneve, shoqërisë civile, akademisë, sektorit privat, të rinjve dhe partnerëve zhvillimorë, që ka shqyrtuar sfidat, qëllimet dhe treguesit e SKZH 2030, në faza të ndryshme të procesit.
- **Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS)**, e Zyrës së Kryeministrit ka koordinuar gjithë procesin e hartimit të SKZH-së.

Procesi i hartimit të SKZH 2030 është mbështetur nga partnerë zhvillimorë. Si partner kryesor, Komisioni Evropian e ka mbështetur procesin në konceptimin e reformës në sistemin e planifikimit strategjik, nëpërmjet projektit “Mbështetje për Zyrën për Planifikim Strategjik”. Agjencitë e OKB-së kanë ofruar mbështetje në fusha të ndryshme, në veçanti Zyra e Koordinatorës për Zhvillim, nëpërmjet këshillave dhe ekspertizës së vazhdueshme për sigurimin e ndërlidhjes së SKZH 2030 me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Po ashtu, Qeveria Gjermane, nëpërmjet Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), e ka mbështetur procesin duke ofruar ekspertizë për shtyllën sigurisë dhe sundimit të ligjit dhe shtyllën e zhvillimit të barabartë njerëzor.

3. Analizë e gjendjes aktuale

Hapi i dytë për përgatitjen e SKZH 2030 ka përfshirë analizën e gjendjes aktuale për secilin sektor veç e veç. Nëpërmjet metodologjisë së përparësive, mangësive, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT), është krijuar baza për hartimin e SKZH 2030. Analiza paraqet dëshmi rreth zhvillimit social e ekonomik dhe pabarazive, duke marrë parasysh gjendjen aktuale në Kosovë, trendet rajonale dhe evropiane, sfidat për zhvillim social dhe ekonomik, pabarazitë sociale të identifikuara, grupet e cënueshme dhe zotimet e obligimet ndërkombëtare të marra nga Kosova.

Konteksti i përgjithshëm

Për më shumë se dy dekada, Kosova e ka katërfishuar ekonominë e saj, ndonëse nga një bazë fillestare tejet e ulët, si pasojë e dëmeve të luftës. Gjatë viteve 2017-2019, Kosova ka tejkaluar vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, sa i përket rritjes së BPV-së reale, duke shënuar normë mesatare prej 4.3%. Shpërthimi i pandemisë COVID-19 bëri që hovi i rritjes të ndalet. Sikurse të ngjashme me vendet tjera, Kosova përjetoi tkurrje të BPV-së reale prej 5.3% në vitin 2020, e cila megjithatë është ringjallur suksesshëm në vitin 2021. Kontribut të veçantë në rritjen ekonomike të vendit përgjatë viteve kanë dhënë konsumi, i nxitur në masë të madhe nga diaspora dhe ndihma e jashtme. Mbështetja e diasporës në formë të remitencave është rritur vazhdimisht, duke shënuar rekord në vitin 2021, me mbi 1.1 miliardë Euro.⁴

⁴ Banka Qendrore e Kosovës. Seritë kohore – remitencat. Shkurt 2022.

Tabela 1. Treguesit kryesorë social dhe ekonomik

Treguesi	2017	2018	2019	2020	2021
Norma e rritjes së BPV-së reale (%)	4.2	3.4	4.8	-5.3	9.1
BPV (mil. EUR)	6,356.4	6,671.5	7,056.1	6,771.6	-
BPV për kokë banori (US\$)	3.957	4.388	4.416	4.350	5.508
Norma e papunësisë (%)	30.5	29.6	25.7	25.9	-
Papunësia e grave (%)	36.6	38	34.4	32.3	-
Papunësia te të rinjtë (15-24 vjeç) (%)	50.9	57.3	49.4	49.1	-
- Papunësia e vajzave (%)	63.5	64.7	57.6	57.2	-
- Papunësia e djemve (%)	48.4	51.5	44.8	45.2	-
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e të rinjve	27.1	28.9	32.7	33.6	-
Pjesëmarrja në fuqinë punëtore (%)	43	42	40.5	38.3	-
- Pjesëmarrja e grave (%)	20	18.4	22.4	20.8	-
- Pjesëmarrja e burrave (%)	65.3	63.3	60.2	56	-
Norma e inflacionit (%)	1.5	1.1	2.7	0.2	3.4
Borxhi publik (si % e BPV-së)	16.2	16.9	17.5	21.8	-
Deficiti tregtar (% e BPV-së)	0.29	0.32	0.31	0.36	-
Eksportet – mallrat (mil. EUR)	378	367.5	383.5	474.9	749.7
Importet – mallrat (mil. EUR)	3,047.0	3,347.0	3,496.9	3,296.0	4,652.7
Eksportet – shërbimet (mil. EUR)	1,358.8	1,561.6	1,675.1	994.9	1,954.4
Importet – shërbimet (mil. EUR)	531.5	705.8	749.1	603.3	870.7
Shkalla e varfërisë (% e popullsisë)	18	-	21.1	23.2	19.4
Investimet e Huaja Direkte (mil. EUR)	255.4	272.1	254.6	345.7	415.3
Investimet e Huaja Direkte (% e BPV-së)	4.0	4.1	3.6	5.1	-
Remitencat (mil. Euro)	759	800	851,5	980	1,153.4

Burimi: BQK, ASK, BB


Inflacioni dhe borxhi publik, kanë qenë nën kontroll përgjatë viteve, duke e ruajtur stabilitetin makroekonomik të vendit. Megjithatë, ngritja e çmimeve në nivel global, kryesisht si rezultat i krizës së energjisë dhe luftës në Ukrainë, ka filluar të ketë pasoja edhe në Kosovë. Norma e inflacionit prej 3.4% në vitin 2021, është më e larta në pesë vitet e fundit⁵, ndërsa trendi është ende më shqetësues në fillim të vitit 2022 (8.95% në katër muajt e parë të 2022)⁶. Trend në rritje është vërejtur edhe tek borxhi publik, ndonëse jo i përmasave të inflacionit.

Struktura ekonomike ekzistuese në Kosovë është kryesisht e përqendruar në aktivitete prodhuese dhe shërbyese, të cilat aktualisht kanë performancë dhe produktivitet të ulët dhe me pak potencial që garanton rritje të qëndrueshme në të ardhmen. Industrinë e bazuar në teknologji mesatare ose të lartë dhe shërbimet e tregut që kërkojnë dije, përbëjnë vetëm 1%, respektivisht 8% të vlerës së shtuar në vend. Ndonëse sektori privat është prijatar në ekonominë e Kosovës, ende është i brishtë dhe i dominuar nga mikro ndërmarrjet e me kapital të kufizuar.

Shërbimet përbëjnë pjesën më të madhe të ekonomisë së Kosovës, me pjesëmarrje prej 47.5% në BPV dhe 65% të punësimit.⁷ Tregtia me shumicë dhe pakicë, patundshmëria, transporti dhe shërbimet financiare, janë sektorët më të mëdhenj të shërbimeve të ekonomisë së Kosovës. Industria përbën rreth 26.4% të BPV-së, me kontributin më të lartë që vjen nga sektorët e prodhimit dhe ndërtimit (11.7% dhe 8.5% të BPV-së).⁸ Kontributi i bujqësisë në BPV-në e Kosovës, ka rënë në masë të madhe gjatë dekadës së fundit, nga 15% në vitin 2008 në 6.9% në vitin 2019, ndonëse ende kontribuon me një përqindje të konsiderueshme të punësimit (5.5% të punësimit formal dhe 35% të punësimit jo formal).⁹

Kosova është ekonomi relativisht e hapur. Indeksit të Hapjes, i cili tregon pjesëmarrjen e tregtisë në BPV-në e vendit, Kosova ka shënuar një mesatare prej rreth 80% në periudhën 2017-2020. Bilanci tregtar është negativ, me një deficit përbën mesatarisht rreth 32% të BPV-së në periudhën e njëjtë. Importi tejte i lartë i mallrave kontribuon më së shumti në këtë deficit, ndërsa suficiti në tregtinë e shërbimeve, arrin ta sheshojë atë deri në masë të caktuar.

Figura 2. Bilanci tregtar 2017-2021



Burimi: ASK

Tregtinë më të madhe Kosova e realizon me vendet fqinje dhe shtetet e BE-së, në kuadër të CEFTA-s, respektivisht MSA-së. Eksportet e Kosovës, ashtu siç është struktura e ekonomisë, nuk përmbajnë aq vlerë të shtuar dhe karakterizohen me shkallë të ulët të mbijetesës në tregjet e huaja. Megjithatë, trendi pozitiv në vitin 2021, sa i përket eksportit të mallrave të prodhuara, është një tregues i rëndësishëm për potencialin e zhvillimit të industrisë me vlerë të shtuar.

5 ASK. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit. Dhjetor 2021.

6 ASK. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit. Prill 2021

7 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

8 Ibid.

9 Ibid.

Sa i përket investime në Kosovë, në tri vitet e fundit, vlerësohet që vetëm 17% e tyre kanë shkuar në kapital prodhues. Investimet e Huaja Direkte (IHD), që zakonisht ofrojnë shtytje për një përmirësim të gjerë të ekonomisë, në raport me BPV mbeten nën mesataren vendeve fqinje, ndonëse kanë shënuar një trend pozitiv duke e arritur vlerën më të lartë në pesë vitet e fundit (415.3 milionë Euro në vitin 2021). Pjesa më e madhe e këtyre investimeve vijnë nga diaspora kosovare, kryesisht e vendosur në Gjermani dhe Zvicër, të orientuara në sektorë që sjellin pak efekte përhapëse në ekonomi. Në sektorët ku më së shumti investohet kapitali i huaj janë patundshmëria dhe shërbimet financiare. Në anën tjetër, dy sektorë me potencial të madh, prodhimi dhe teknologjia e informimit dhe komunikimit (TIK), përbëjnë vetëm 3.3% të totalit të IHD-ve në vitin 2021.¹⁰


Kosova ka thjeshtuar procedurat administrative për lehtësimin e themelimit dhe operimit të një biznesi. Ky përmirësim e ka rritur ndjeshëm pozicionin në vlerësimet krahasuese ndërkombëtare. Pavarësisht kësaj, ndërmarrjet kosovare ende vazhdojnë të përballen me sfida të shumta, që kufizojnë konkurrueshmërinë e tyre dhe vështirësojnë integrimin në zinxhirët global të vlerës. Qasja e kufizuar në financa, konkurrenca e pandershme, kapacitetet e ulëta për inovacion, janë pengesa serioze në këtë drejtim. Kjo ka pasur efekt të madh në tregun e punës, me ç'rast fuqia punëtore është orientuar drejt punësimit në sektorin publik. Përveç kësaj, niveli i lartë i remitencave, që ka ndikuar në pagën e rezervimit tek popullsia, ka zvogëluar pjesëmarrjen në tregun e punës dhe punësimin në sektorin privat.

Siguria e furnizimit me energji elektrike është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Sfidat në sektorin e energjisë përfshijnë aspekte të ndryshme, duke filluar me furnizimin e pamjaftueshëm dhe paqëndrueshëm nga termocentralet e vjetra të bazuara në linjit, konsumin jo eficient të energjisë dhe zhvillimin e pamjaftueshëm të burimeve alternative të prodhimit dhe furnizimit me energji. Në anën tjetër, rrjeti i transportit në Kosovë mbetet i kufizuar, që ndikon në ofertën e Kosovës si vend i lakmueshëm për investime. Investimet e kufizuara në modernizimin dhe zgjerimin e transportit hekurudhor kanë ndikuar që ky modalitet i transportit të mbetet prapa në krahasim me ekonominë e ngjashme. Mungesa e transportit hekurudhor të zhvilluar ka ndikim posaçërisht në transportin e mallrave, që e rritë koston e tregtisë dhe ekspozon vendin ndaj efekteve negative mjedisore. Pavarësisht investimeve në transportin rrugor, integrimi në korridoret pan-evropiane të transportit, mbetet nën nivelin e kënaqshëm.

Rritja ekonomike në Kosovë nuk është përkthyer në përmirësim të ndjeshëm të parametrave zhvillimorë. Përkundër përqindjes së lartë të popullsisë në moshë pune (rreth 65%), Kosova vazhdon të ketë papunësinë më të lartë në Evropë, me një normë prej 25.9% në vitin 2020. Kjo sfida është posaçërisht e theksuar tek të rinjtë (48.6%) dhe gratë (29.7%). Përveç kësaj, Kosova ka nivel të lartë të pasivitetit në tregun e punës, ku vetëm 39.5% e popullsisë në moshë pune janë aktiv në tregun e punës, ndërsa vetëm 22.7% e grave të moshës së punës marrin pjesë në treg të punës.

Figura 3.

Shkalla e papunësisë 2017-2021



Burimi: ASK

Është shqetësuese shkalla e lartë e të rinjve që nuk janë duke u shkolluar, trajnuar ose aktiv në tregun e punës (NEET), që është 29.8%. Në anën tjetër, arsyet e emigrimit që lidhen me tregun e punës janë në rritje e sipër, e vlerësuar me 38% të leje qëndrimeve, për herë të parë në vitin 2019, krahasuar me 17% në vitin 2010. Në të njëjtën periudhë, emigrimi për arsye familjare ka rënë nga 63% në 21%. Planet e emigrantëve kosovarë për të jetuar jashtë, nuk duket të jenë të përkohshme, pasi që bazuar në të dhënat e EUROSTAT-it, 60% e leje qëndrimeve për herë të parë në vitin 2019, janë dhënë për më shumë se dymbëdhjetë muaj, 32% për gjashtë deri njëmbëdhjetë muaj dhe vetëm 8% për tre deri pesë muaj. Prandaj, emigracioni pritet të ketë një ndikim afatgjatë në demografinë dhe fuqinë punëtore të Kosovës. Në veçanti, kjo është e theksuar me shkallën e lartë të emigrimit të të rinjve, sidomos mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor.

Kosova ballafaqohet me një numër sfidash që lidhen me mjedisin dhe burimet natyrore. Ndotja e ajrit është njëra nga sfidat kryesore në këtë drejtim që ndikon drejtpërdrejt në cilësi të jetesës në Kosovë. Si rezultat i vlerave të larta të grimcave të imta PM2.5, sidomos në zona urbane gjatë dimrit, në Kosovë vlerësohet të humben afërsisht 2,500 vite jetë në 100,000 banorë. Në këtë aspekt, Kosova qëndron në vendin më të ulët në Ballkanin Perëndimor. Prodhimi i energjisë elektrike i bazuar kryesisht në linjit, përdorimi i drurit-biomasës dhe qymyrit për ngrohje të njësive të banimit dhe transporti, mbeten ndër shkaktarët kryesorë të ndotjes. Mbeturinat nuk menaxhohen në mënyrën më të mirë, nuk ka mbulueshmëri universale në mbledhje të mbeturinave dhe ripërtërihen vetëm rreth 2-5% e tyre që mblidhen. Sfidë tjetër me rrezikshmëri në të ardhmen, janë burimet e kufizuara ujore dhe kapacitetet e ulëta për ruajtjen e ujit. Në anën tjetër, shpyllëzimi dhe shfrytëzimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore ka ndikuar në biodiversitet. Gjithashtu, Kosova përballlet me rritje të temperaturave, zjarre të pyjeve, valë të nxehtëti dhe përmbytje. Në këtë kontekst, raporti i Panelit Ndërqeveritar për Ndryshime Klimatike, e konsideron Ballkanin Perëndimor si zonë e ndikuar nga ndryshimet klimatike, duke kërcënuar kështu qasjen në burime natyrore dhe jetesën në të ardhmen.

Cilësia e arsimit mbetet ende nën nivelet e dëshiruara dhe kjo është shpërfaqur me rezultate më të dobëta në testimet ndërkombëtare, si në rastin e testit PISA. Përveç kësaj, në aspektin e mësimdhënies, numri i mësimdhënësve që marrin pjesë në programe të zhvillimit profesional është vetëm 25% e totalit. Pjesëmarrja në arsim në fëmijërinë e hershme është vetëm 15%. Me anë të legjislacionit dhe kornizave institucionale, Kosova ka arritur që në nivel vendi ta zbres në 2.1% shkallën e fëmijëve jashtë shkollës, por për fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali, dhe Egjiptian kjo shifër është e lartë, apo mbi 13%. Shpenzimet e parapara për arsim mbesin të ulëta në përgjithësi, ku vetëm rreth 4% e shpenzimeve të buxhetit të Kosovës i dedikohen Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Shkenca dhe hulumtimi vazhdojnë të jenë fusha shumë pak të financuara, ku vetëm 0.1% e BPV-së i dedikohet hulumtimit shkencor. Për më tepër, mungesa e ndërlidhjes së arsimit me tregun e punës shfaqet në formën e hendekut të dukshëm të shkathtësive në treg, duke ndikuar edhe nivelin e punësimit dhe zhvillimit të sektorit privat. Pjesëmarrja e ulët e arsimit në fëmijërinë e hershme, përveç efekteve negative në shkollim në afat të gjatë, ka ndikuar drejtpërdrejt edhe nivelin e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore, sidomos në pjesëmarrjen e nënave në tregun e punës.

Në anën tjetër, pandemia COVID 19, përveç ndikimit negativ në ekonomi, arsim, dhe mirëqenie, pandemia orientoi vëmendjen drejt shëndetësisë, duke theksuar problemet sistematike nga të cilat lëngon ky sektor. Ndonëse sistemi i kujdesit shëndetësor është falas, qasja në kujdes shëndetësor shpalos pabarazi të dukshme. Duke qenë që Kosova ende nuk ka sistem funksional të sigurimit shëndetësor publik dhe vetëm 6.8% të popullsisë ka sigurim privat, qytetarët e Kosovës bartin rreth 40% të kostos totale për kujdes shëndetësor, në krahasim me mesataren prej 13% në vendet e OECD.¹¹ Për më tepër, Kosova përballlet me mungesë të personelit mjekësor në disa lëmi specifike, duke marrë parasysh shkallën e lartë të emigrimit të të rinjve, sidomos të mjekëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

Sistemi i mbrojtjes sociale është ndërtuar në baza *ad hoc* dhe nuk është i dizajnuar që t'i shërbej grupeve më të cenuara të shoqërisë. Kosova vlerësohet të jetë shteti më i varfër në Evropë, ku 29.7% e popullsisë jeton në varfëri dhe rreth 7% në varfëri të skajshme. Prej pesë kategorive

11 OECD (2021), Vlerësimi shumëdimensional i Ballkanit Perëndimor: Vlerësimi i mundësive dhe pengesave, OECD Development Pathways, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/4d5c9c2a-en>.

përbërëse dhe 24 skemave, Skema e Ndhmës Sociale është e vetmja skemë që synon direkt të ulë varfërinë nëpërmjet transfereve të fokusuara të parasë, kurse skemat tjera të mbrojtjes sociale synojnë grupe specifike. Pensioni bazik në vlerë të ulët dhe problemet e trashëguara nga ndërrimi i sistemit dhe luftës, ndjehen veçanërisht tek kontributet pensionale, si dhe bëjnë që të pensionuarit e Kosovës të jetojnë në rrezik varfërie, përfshirë edhe ata që mund të kenë shumë vite pune përgjatë karrierës së tyre.

Kosova është e përkushtuar të kontribuojë për siguri dhe paqe në botë, duke u rreshtuar kështu në linjë me aleatët tradicional. Mjedisi global i sigurisë karakterizohet nga paqëndrueshmëria dhe paqartësia, prandaj sfidat, rreziqet dhe kërcënimet janë komplekse dhe me ndikim në sigurinë e shteteve dhe qytetarëve. Kosova ka treguar gatishmërinë e saj për ndarjen e barrës për të strehuar dhe integruar refugjatët. Në këtë drejtim, është me rëndësi të fuqizohen kapacitetet për të trajtuar lëvizjet e përziera të refugjatëve në mënyrë më të parashikueshme, efikase dhe më të ndjeshme ndaj mbrojtjes së tyre. Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO mbetet e paqartë, duke marrë parasysh numrin e shteteve që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Në vitet e fundit, buxheti i ndarë për mbrojtje është rritur, që konsiderohet hap i rëndësishëm drejt ngritjes së kapaciteteve për siguri dhe mbrojtje.

Gjyqësori është në proces të reformimit, si pasojë e sfidave të dukshme të faktuara edhe në raporte të huaja, sikur Raporti i Vendit i BE-së. Administrimi i drejtësisë mbetet i ngadaltë dhe joefikas. Ndonëse ka pasur përparim në ruajtjen e një strukture të qartë të gjyqësorit, efikasiteti i tij mbetet i ulët, me kohë të gjatë të zgjidhjes të rasteve, besim të ulët të qytetarëve në drejtësi, nivel të ulët të zbatimit të kontratave dhe numër të madh të rasteve të grumbulluara. Efikasiteti i drejtësisë penale pengohet seriozisht si rezultat i mangësive në legjislacionin penal.

Sa i përket sigurisë publike, Raporti i Vendit i Komisionit Evropian vlerëson se Kosova ende përballet me një nivel të ulët të hetimit, ndjekjes penale dhe dënimit të krijimit të organizuar dhe të konfiskimit të aseteve, ndonëse kohëve të fundit, janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të fuqizuar kornizën ligjore dhe institucionale në këtë drejtim. Sfida të tjera sa i përket sigurisë publike mbesin luftimi i korrupsionit, lufta kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, dhe trafikimit të drogës. Me theks të veçantë, dhuna në baza gjinore mbetet një aspekt me rëndësi për t'u adresuar, si në nivel të institucioneve të zbatimit të ligjit ashtu edhe gjyqësorit.

Ndonëse janë bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të reformës së administratës publike, e në veçanti reformës së menaxhimit të financave publike, vlerësohet se viteve të fundit nuk ka pasur progres të mjaftueshëm si pasojë e ndryshimeve të shpeshta të qeverive. Sfidat kryesore ndërliqden me kapacitetet e administratës publike për të planifikuar dhe arritur rezultate. Vlerësohet se Kosova ka një administratë të madhe si përqindje e punësimit të përgjithshëm dhe pabarazi gjinore në punësim në sektorin publik. Kosova ka bërë hapat e parë drejt digjitalizimit të shërbimeve. Platforma e-Kosova duhet të avancohet për lehtësimin në ofrimin e shërbimeve ndërsa zvogëlimin e barrës administrative për bizneset dhe qytetarët duhet shtyrë përpara. Kosova ka arritur të mbajë një nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë makrofikale, por sfida mbetet shkalla e lartë e ekonomisë jo formale, përfshirë borxhet e mëdha tatimore të individëve dhe ndërmarrjeve.

E ardhmja e Kosovës është e përqendruar drejt integritimit Euro-Atlantik, si vend potencial kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Në krahasim me shtetet e rajonit, Kosova mbetet e fundit sa i përket procesit të anëtarësimit. Kosova ka marrëveshje kontraktuale me BE-në, ku Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ka hyrë në fuqi në vitin 2016. MSA parashihet të zbatohet brenda një periudhe 10 vjeçare dhe përmban obligime institucionale dhe ligjore në fusha të ndryshme. Përderisa integrimi në NATO është synim, zyrtarisht Kosova nuk është pjesë e zgjerimit të kësaj organizate, pasi nuk e ka nënshkruar as Partneritetin për Paqe. Pesë shtetet mosnjohëse të BE-së dhe katër shtetet mosnjohëse të NATO-s paraqesin pengesa serioze për rrugën integruese të Kosovës.

Në politikën e jashtme Kosova përballet me sfida të mëdha për shkak të mos njohjes ende të pavarësisë nga ana e shumë shteteve, si dhe mos anëtarësimi në organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në politikën e jashtme, qasja destruktive e Serbisë ndaj Kosovës dhe rajonit paraqet sfida të vazhdueshme. Lëvizjet e fundit si pasojë e luftës në Ukrainë, dëshmuar edhe një herë se gjendja aktuale nuk është e qëndrueshme dhe e bëjnë më urgjente anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

4. Vizioni dhe prioritetet zhvillimore të Kosovës

SKZH do të shërbejë si mekanizëm për zbatimin e vizionit strategjik për një periudhë afatgjatë, përmes përcaktimit të prioriteteve zhvillimore, objektivave strategjike dhe rezultateve që pritet të arrihen. Zbatimi i këtij vizioni duhet të kontribuojë në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim të vendit në strukturat e Euro-Atlantike, dhe njëkohësisht përkushtimin për zbatimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ).

4.1. Vizioni

Vizioni përcakton drejtimin afatgjatë për zhvillim të qëndrueshëm, duke marr parasysh vlerat dhe synimet për vendin dhe shoqërinë.

Vizioni i Kosovës 2030 është:

“Kosovë e zhvilluar, me ekonomi të qëndrueshme, mirëqenie, siguri dhe barazi, e integruar në tregjet dhe organizatat ndërkombëtare, me institucione dhe administratë efektive, standarde të ngritura të jetesës për të gjitha grupmoshat, me cilësi dhe qasje të mirëfilltë në drejtësi, shëndetësi dhe arsim.”

Realizimi i vizionit nëpërmjet përmbushjes së qëllimeve zhvillimore, do të mundësojë arritjen e mirëqenies për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

4.2. Shtyllat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030

Për të adresuar sfidat e zhvillimit të vendit dhe për të arritur vizionin për Kosovën 2030, SKZH 2030 përmban katër shtylla:

- I. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik
- II. Zhvillimi i barabartë njerëzor
- III. Siguria dhe sundimi i ligjit
- IV. Qeverisja e mirë

Duke zbatuar drejtimet zhvillimore të SKZH 2030, Kosova parashihet si vend me:

- Zhvillim ekonomik i bazuar në përmirësim të mjedisit biznesor dhe transformim të ekonomisë drejt aktivitete me vlerë të shtuar, me fokus në digjitalizim e inovacion dhe me konsideratë për mjedisin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Qasje të barabartë në arsim cilësor, që kontribuon në kapital të fuqishëm njerëzor dhe standarde më të larta të jetesës për të gjithë qytetarët e të gjitha grupmoshave;
- Institucione efektive të bazuara në demokracinë pjesëmarrëse, që janë të përkushtuara për paqe, respektimin e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin social dhe ekonomik;
- Zhvillim i qëndrueshëm, i bazuar në rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë, transformimin e sistemit të transportit urban, sistem modern të menaxhimit të mbeturinave dhe menaxhim të qëndrueshëm të ujit, që rezulton në jetë më të shëndetshme dhe më të gjatë.

Figura 4. Shtyllat zhvillimore për arritjen e vizionit Kosova 2030



5. Qëllimet zhvillimore

Përbushja e vizionit për Kosovën 2030, do të arrihet nëpërmjet qëllimeve zhvillimore dhe strategjike të shtrira në të gjithë sektorët e politikave publike. SKZH 2030 përmban 11 qëllime zhvillimore, për përbushjen e katër prioritetëve kryesore zhvillimore:

Figura 5. Qëllimet Zhvillimore të SKZH-së 2030



ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK

- Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese
- Infrastrukturë cilësore, e qëndrueshme dhe e integruar
- Mjedis i pastër dhe shfrytëzim efikas i burimeve natyrore



ZHVILLIMI I BARABARTË NJERZOR

- Arsim i qasshëm dhe cilësor
- Punësim i lartë, i denjë dhe gjithëpërfshirës
- Shëndet dhe mirëqenie e përmirësuar
- Kulturë kreative dhe shoqëri aktive



SIGURIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

- Gatishmëri e lartë për paqe dhe siguri
- Drejtësi efektive










QEVERISJE E MIRË






- Qeveri efektive dhe llogaridhënëse
- Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar

Matja e qëllimeve zhvillimore do të bëhet nëpërmjet treguesve të ndikimit, të përzgjedhur si tregues që mbulojnë një gamë të gjerë të çështjeve dhe që synojnë eliminimin e sfidave kryesore për zhvillim. Qëllimet strategjike do të maten nëpërmjet treguesve të ndikimit për sektorë të cilët janë të lidhura drejtpërdrejtë me një sektor të politikave publike dhe shërbejnë si udhërrëfyes për definimin e kornizës strategjike sektoriale. Me qëllim të vendosjes së planifikimit koherent, janë definuar 16 sektorët e politikave publike, duke u bazuar në klasifikimin e funksioneve të qeverisë (COFOG), që shërbejnë për ndërlidhjen me kornizën financiare. Në Shtojcën A, janë paraqitur qëllimet dhe treguesit në mënyrë më të hollësishme.






Tabela 2. Pasqyra e shtyllave të SKZH 2030, qëllimet, sektorët dhe OZHQ-të

Qëllimet zhvillimore	Sektori	Qëllimet strategjike	MSA	OZHQ	
1 Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese 	10. Mbështetje për industrinë dhe biznesin	1.1 Ndërtimi i mjedisit biznesor të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues	8/20	8 17	
		1.2 Përsheptimi i transformimit digjital dhe inovacionit tek NVM-të dhe startup bizneset	8/10/20	9 12 2	
		1.3 Zhvillimi i industrisë drejt produkteve dhe shërbimeve me vlerë më të lartë të shtuar	20	5	
		1.4 Mobilizimi i industrisë drejt ekonomisë qarkore	27		
		1.5 Ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve dhe ulja e varësisë së tepërt në importe	20/30		
		1.6 Rritja e investimeve të orientuara në eksport	1/4/30		
		1.7 Turizëm i qëndrueshëm dhe konkurrent në rajon	20/26		
	11. Bujqësia	1.8 Përmirësimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi	11		
		1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve e shitësve me pakicë	12		
	<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;"> 8 PUNË DIMALTOZE DHE RITJE EKONOMIKE </div> <div style="text-align: center;"> 17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT </div> <div style="text-align: center;"> 9 INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË </div> <div style="text-align: center;"> 12 KONSUM DHE PRODHIM I PËRQJEGJESHËM </div> <div style="text-align: center;"> 5 BARAZI GJINDORE </div> <div style="text-align: center;"> 2 ZERO URI </div> </div>				
	2 Infrastrukturë e cilësisë së lartë, e qëndrueshme dhe e integruar 	09. Energjia	2.1 Përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji, qëndrueshmërisë dhe përballueshmërisë	15	9 7 11
			2.2 Integrimi në tregjet rajonale dhe pan-evropiane të energjisë	15	
		08. Transporti dhe komunikimi	2.3 Përmirësimi infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit	14/21	
			2.4 Krijimi i lidhjeve pa pengesa në transportin ndërkombëtar multimodal	14/21	
			2.5 Rritja e sigurisë së transportit	14/21	
			2.6 Zhvillimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik me brez të gjerë me cilësi të lartë	10	
			2.7 Përmirësimi i lidhjeve ndërkombëtare në telekomunikacion	10	
	<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;"> 9 INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË </div> <div style="text-align: center;"> 7 ENERGJIE PËRBALLUESHME DHE E PASTER </div> <div style="text-align: center;"> 11 QYTETE DHE KOMUNITETE TË QENDRUESHME </div> </div>				


Qëllimet zhvillimore	Sektori	Qëllimet strategjike	MSA	OZHQ
3 Mjedis i pastër dhe shfrytëzim më i mirë i burimeve natyrore 	07. Mjedisi	3.1 Menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe rritja e qarkullimit të burimeve	27	7 11
		3.2 Përmirësimi i qasjes në ujë dhe kanalizim, dhe reduktimi i ndotjes së ujërave	27	13 8
	09. Energjia	3.3 Rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në miksin energjetik	15	6 15
		3.4 Përmirësimi i efikasitetit të energjisë	15	
		3.5 Përmirësimi i disponueshmërisë së ujit dhe efikasitetit	27	
	08. Transporti dhe komunikimi	3.6 Promovimi i mobilitetit digjital dhe të qëndrueshëm	14/27	
	07. Mjedisi	3.7 Menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe mbrojtja e biodiversitetit	27	
		3.8 Planifikimi i përgjegjshëm dhe zhvillimi i integruar i territorit	27	
     				
Agjendat horizontale: 1. Agjenda digjitale; 2. Agjenda e Gjelbër; 3. Migrimi dhe diaspora; 4. Gjithëpërfshirja;				



4 Arsim i qasshëm dhe cilësor 	16. Arsimi dhe shkenca	4.1 Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukim dhe kujdes cilësor në fëmijërinë e hershme	26	4 5 8
		4.2 Përmirësimi i qasjes gjithëpërfshirëse dhe digjitalizimit në shërbimet arsimore	26	10
		4.3 Harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës	19/26	
		4.4 Cilësi, integritet dhe konkurrueshmëri më të lartë në arsimin e lartë	19/25/26	
		4.5 Zhvillimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit		
   				

Qëllimet zhvillimore	Sektori	Qëllimet strategjike	MSA	OZHQ
5 Punësim i lartë, i dinjitetshëm dhe gjithëpërfshirës 	13. Tregu i punës dhe punësimi	5.1 Zhvillimi i shkathtësive dhe ngushtimi i hendekut në tregun e punës	19	8 5
		5.2 Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës	19/26	10 4
		5.3 Përmirësimi i kushteve të punës dhe shërbimeve të punësimi	19	
6 Shëndet dhe mirëqenie e përmirësuar 	15. Shëndetësia	6.1 Përmirësimi i kualitetit dhe qasjes në shërbime shëndetësore	28	1 8
		6.2 Mënyrë më e shëndetshme e jetesës	28	3 5
	14. Kujdesi social	6.3 Përmirësimi i targetimit dhe shpërndarjes së mbrojtjes sociale	19	10
		6.4 Qasje më e mirë në shërbime sociale	19	
		6.5 Qasje në strehim të denjë, të përballueshëm, dhe cilësor	19	
		6.6 Qasje në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt dhe me vlera ushqyese për të përmbushur nevojat dietale për jetë të shëndetshme		
7 Kulturë kreative dhe shoqëri aktive 	12. Kultura dhe sporti	7.1 Art dhe kulturë për mirëqenie dhe zhvillim	23	4
		7.2 Forcimi i mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore	20/26	
		7.3 Shoqëri aktive dhe e shëndetshme përmes aktivitetit sportiv		
		7.4 Fuqizimi i të rinjve në jetën ekonomike dhe sociale të vendit		
		7.5 Konsolidimi i imazhit shtetëror përmes artit dhe sportit		
		7.6 Turizmi sportiv dhe kulturor		

Qëllimet zhvillimore	Sektori	Qëllimet strategjike	MSA	OZHQ	
8 Gatishmëri e lartë për paqe dhe siguri 	04. Mbrojtja dhe siguria	8.1 Fuqizimi i kapaciteteve për mbrojtje dhe siguri në bashkëpunim me partnerët Euro-Atlantikë	24/31	16	
		05. Siguria publike	8.2 Gatishmëri e lartë për reagim dhe emergjenca	31	
			8.3 Luftimi i krimit dhe korrupsionit	23/24	
			8.4 Siguri e lartë në bashkësi	23/24	
	16 PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA 				
9 Drejtësi efektive 	06. Drejtësia	9.1 Drejtësisë me kohë	23	16	
		9.2 Profesionalizëm, pavarësi dhe llogaridhënie në drejtësi	23	5	
		9.3 Qasje e mirëfilltë në drejtësi	23		
	16 PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA  5 BARAZI GJINDORE 				

Agjendat horizontale: 1. Agjenda digjitale; 2. Gjithëpërfshirja

10 Qeveri efektive dhe llogaridhënëse 	01. Qeveri dhe administratë publike	10.1 Rritja e cilësisë në zhvillimin e politikave dhe ofrimin shërbimeve për qytetaret dhe bizneset	32	16
		10.2 Rritja e efektivitetit të shërbimit publik dhe llogaridhënies në administratën publike	32	5
		10.3 Rritja e performancës së komunave	32	
	02. Financat publike	10.4 Përmirësimi i performancës dhe menaxhimit financiar të ndërmarrjeve publike	32	
		10.5 Financa publike të qëndrueshme dhe efektive	17/32	
		10.6 Kontroll efektiv i shpenzimit të buxhetit	32	
	16 PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA  5 BARAZI GJINDORE 			

Qëllimet zhvillimore	Sektori	Qëllimet strategjike	MSA	OZHQ
11 Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar 	03. Politika e jashtme dhe marrëdhënie ndërkombëtare	11.1 Fqinjësi e mirë dhe bashkëpunim rajonal	30/31	16
		11.2 Krijimi dhe forcimi i marrëdhënieve më vendet tjera	30/31	
		11.3 Angazhim i shtuar i diasporës në promovimin dhe zhvillimin e Kosovës	30/31	
		11.4 Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të qytetarëve jashtë vendit	30/31	
		11.5 Fuqizimi i Diplomacisë Publike dhe Diplomacisë Ekonomike	30/31	
				

Agjendat horizontale: 1. Agjenda digjitale; 2. Agjenda e Gjelbër; 3. Migrimi dhe diaspora; 4. Gjithëpërfshirja

Vizioni për Kosovën





Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik

3 qëllime zhvillimore

8 tregues të ndikimit

23 qëllime strategjike

61 tregues të rezultatit



Sektorët

07. Mjedisi

08. Transporti dhe komunikimi

09. Energjia

10. Mbështetje për industrinë dhe biznesin

11. Bujqësia

> QËLLIMI 1

Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese

Gjatë dekadës së fundit, Kosova ka treguar performancë të mirë të rritjes ekonomike. SKZH 2030 synon që rritjen ekonomike ta shoqërojë edhe me rritje të punësimit dhe zgjerim të bazës së prodhimit, duke ndryshuar strukturën aktuale ekonomike të vendit, me qëllim të arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm.

Deri në vitin 2030, Kosova synon që të krijojë mjedis të përshtatshëm biznesi dhe të ketë rol aktiv në zhvillimin e një ekonomie konkurruese, drejt aktiviteteve prodhuese dhe shërbyese me vlerë të shtuar. Inovacioni dhe digjitalizimi, si përcaktues të rëndësishëm të konkureshmërisë, së bashku me ekonominë qarkore si model për zhvillim të qëndrueshëm, do të kenë vëmendje të veçantë në trajektoren e re ekonomike. Transformimi ekonomik i Kosovës do të bazohet në ndërmarrje konkurruese, inovative dhe të gjelbra, të integruara në tregje ndërkombëtare.

Për të arritur këtë qëllim, bizneset do të mbështeten për sigurimin e standardeve të cilësisë dhe do të përfitojnë ndihmë financiare për inovacion dhe digjitalizim, me theks të veçantë të gratë ndërmarrëse. Në të njëjtën kohë, do identifikohen e përkrahen “kampionët kombëtarë” të industrisë, si dhe do punohet në mbështetjen e parqeve industriale, me fokus në TIK dhe industri prodhuese/përpunuese. Në kuadër të kësaj, do të zhvillohet dhe promovohet turizmi si një nga sektorët kyç të zhvillimit ekonomik. Gjithashtu, do punohet në drejtim të përmirësimit të mekanizmave inspektues për luftimin e evazionit fiskal dhe ekonomisë jo formale, me qëllim të sigurimit të konkurrencës së drejtë dhe të barabartë.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 1.1

BPV për kokë banori (EUR)

BPV për kokë banori mat prodhimin ekonomik të një kombi për person.

baza:
3,772



▲ 2026
>30

● 2030
>50%

Burimi: ASK

Treguesi i ndikimit 1.2

Eksportet (si % e BPV-së)

Vlera e të gjitha mallrave dhe shërbimeve që eksportohen në raport me BPV-në.


baza:
21.6%



▲ 2026
35%

● 2030
45%

Burimi: ASK & BQK



Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet këtyre qëllimeve strategjike (QS):

- 1.1. Ndërtimi i mjedisit biznesor të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues;
- 1.2. Përsheptimi i transformimit digjital dhe inovacionit tek NVM-të dhe startup;
- 1.3. Zhvillimi i industrisë drejt produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar;
- 1.4. Mobilizimi i industrisë drejt ekonomisë qarkore;
- 1.5. Ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve dhe ulja e varësisë së tepërt në importe;
- 1.6. Rritja e investimeve të orientuara në eksporte;
- 1.7. Turizëm i qëndrueshëm dhe konkurrent në rajon
- 1.8. Përmirësimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi;
- 1.9. Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë.

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës së qëllimeve strategjike:

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
1.1	Indeksi i politikave të NVM-ve: Mjedisi i biznesit (5 pikë maks.)	3.65	4.00	4.50
	Firmat që i konsiderojnë praktikatat e konkurrentëve në sektorin informal si pengesën më të madhe (%)	25.48%	15%	12%
	Shkalla e ekonomisë jo-formale	31.7%	25%	
1.2	Shërbimet mbështetëse të qeverisë për NVM-të inovative (5 pikë maks.)	2.32	3.50	4.00
	Bashkëpunimi biznes-akademi (5 pikë maks.)	0.7	2.5	3.5
	Firmat që prezantuan ose një produkt/shërbim të ri ose një inovacion në procese (%)	36.6%	50%	60%

Q.S	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
	Përdorimi i TIK në ndërmarrje (>10 punëtorë)	55.8%	70%	80%
	Përdorimi i mjeteve të digjitalizimit në procese të përgjithshme të prodhimit/punës (%)	25.02%	35%	45%
1.3	Proporcioni i industrive prodhuese me intensitet më të lartë të teknologjisë në totalin e vlerës së shtuar (% në VShB)	5.6%	9%	11%
	Proporcioni i shërbimeve të tregut me intensitet të dijes në totalin e vlerës së shtuar (% në VShB)	8.8%	14%	18%
	Indeksi i kompleksitetit ekonomik	0.42	0.50	0.80
1.4	Përdorimi i materialit të ricikluar (%)	1-3% (vlerësim i përafërt)	6%	12.5%
	Vlera e shtuar bruto në lidhje me sektorët e ekonomisë qarkore (%)	0.8%	1%	1.2%
1.5	Numri i firmave që eksportojnë rregullisht (të paktën 10,000 EUR në vit)	Mallra: 887 Shërbime: N/A	Mallra: 1,500 Shërbime: N/A	Mallra: 3,000 Shërbime: N/A
	Diversiteti gjeografik i eksporteve (numri i vendeve që përbëjnë 80% të eksporteve)	Mallra: 10 Shërbime: 10	Mallra: 14 Shërbime: 14	Mallra: 18 Shërbime: 18
	Eksportet e mallrave dhe shërbimeve në BE (në mil. euro)	Mallra: 178.3 Shërbime: 586.2	Mallra: >100% Shërbime: >100%	Mallra: >200% Shërbime: >150%
1.6	IHD neto (% e BPV-së)	4.2%	6%	8%
	IHD strategjike në total IHD (%)	3.3%	30%	50%
	Investimet në aktivitete të prodhimit (% e importit të mallrave kapitale në FBKF)	17.4%	23%	27%
1.7	Numri i vizitorëve të huaj/jashtëm	5,607,324 (2021)	Rritje për 30%	Rritje për 60%
1.8	VShB neto për njësi pune vjetore (NJPV) në bujqësi (€)	1,428 EUR	1,700 EUR	2,000 EUR
	Pjesëmarrja e fermave me >2 hektar (%)	69.71%	50%	35%
	Ujitja e tokës bujqësore (ha)	17.719 ha	40,000 ha	66,000 ha

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
1.9	Përpunimi i ushqimit - lënda e parë nga prodhuesit vendas (%)	50%	60%	70%
	Pjesëmarrja e ushqimit vendas në industrinë e përgjithshme ushqimore të shitjes me pakicë (%)	10%	20%	35%

Strategjitë sektoriale

Për zbatimin e këtij qëllimi zhvillimor do të zhvillohet korniza strategjike sektoriale, e cila parasheh veprime konkrete për zhvillimin e industrisë dhe bizneseve:

- Strategjia për mbështetje të bizneseve dhe zhvillimin e industrisë;
- Strategjia për inovacion dhe ndërmarrësi;
- Strategjia sektoriale për bujqësi dhe zhvillim rural.

Krahas strategjive sektoriale, Qeveria e Kosovës do të miratojë Strategjinë për Specializim të Mençur, që identifikon disa sektorë ekonomikë me potencial të lartë për inovacion dhe rritje të konsiderueshme si prioritet në kuadër të politikave publike dhe investimeve në të ardhmen.

Agjendat horizontale

Për zbatimin e këtij qëllimi zhvillimor, vlerë të veçantë ka diaspora. Për këtë qëllim, do punohet në ngritjen e skemave mbështetëse për diasporën me qëllim rritjen e investimeve në iniciativa të përbashkëta me ndërmarrësit lokalë. Nëpërmjet politikave nxitëse dhe programeve të edukimit e aftësisimit, synohet që bizneset të shmangin të gjitha format e diskriminimit në punë, duke synuar kështu rritjen e punësimit të grupeve të cënueshme dhe nënpërfaqësuar në tregun e punës. Mbështetje e veçantë do t'i jepet industrisë së ripërtëritjes dhe ripërdorimit të materialeve, me qëllim të uljes së ndotjes. Po ashtu, do të mbështeten ndërmarrjet që të rrisin efizienzën dhe të ulin konsumin e energjisë. Digjitalizimi i përgjithshëm i procesit të prodhimit dhe punës do të jetë një nga synimet deri në vitin 2030.

Integrimi Evropian

Ky qëllim zhvillimor është ngushtë i lidhur me agjendën e integrimit evropian, respektivisht me të drejtën për themelimin e kompanive dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve (Kapitulli 3), politikat e konkurrencës (Kapitulli 8), politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë (Kapitulli 20) dhe marrëdhëniet me jashtë (Kapitulli 30).

Përbushja e këtij qëllimi zhvillimor do të ndikoj drejtpërdrejtë në arritjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG), respektivisht objektivave 5, 8, 9, 12 dhe 17.



> QËLLIMI 2

Infrastrukturë e cilësisë së lartë, e qëndrueshme dhe e integruar

Infrastruktura e transportit, energjisë dhe komunikimit është qenësore për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik. Rritja e produktivitetit në ekonomi dhe integrimi dhe përmirësimi i mirëqenies në përgjithësi kërkojnë investime edhe në infrastrukturë.

Te transporti, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të infrastrukturës së transportit hekurudhor, si opsion i rëndësishëm për transportin e mallrave, duke rehabilituar dhe zgjeruar rrjetin hekurudhor dhe ndërlidhjen e tij me vendet fqinje. Në fushën e energjisë, do të rriten investimet në infrastrukturën energjetike dhe krijimin e kapaciteteve për ruajtjen e energjisë së prodhuar, me qëllim të sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm.

Sa i përket infrastrukturës së komunikimit, e cila ka një shtrirje të kënaqshme, fokus do të jetë ndërlidhja me vendet tjera, me qëllim të lehtësimit të përpjekjeve për kalim drejt ekonomisë digjitale, duke përfshirë edhe krijimin e infrastrukturës së rrjetit 5G. Në këtë kontekst, deri në vitin 2030, Kosova synon ndërtimin e një infrastrukturë cilësore, të integruar, të përshtatshme për ndryshime, e sigurtë, e qëndrueshme dhe miqësore për mjedisin.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 2.1

Infrastruktura (0-100)

Indeksi Global i Konkurueshmërisë mat cilësinë e infrastrukturës.

baza:
63.66

2026
Mesatarja e BP

2030
Mesatarja e BP

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet përmes këtyre qëllimeve strategjike:

- 2.1. Përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji, qëndrueshmërisë dhe përbalueshmërisë;
- 2.2. Integrimi në tregjet rajonale dhe pan-evropiane të energjisë;
- 2.3. Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit;
- 2.4. Krijimi i lidhjeve pa pengesa në transportin ndërkombëtar multimodal;
- 2.5. Rritja e sigurisë së transportit;
- 2.6. Zhvillimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik me brez të gjerë me cilësi të lartë;
- 2.7. Përmirësimi i lidhjeve ndërkombëtare në telekomunikacion.

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës së qëllimeve strategjike:

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
2.1	Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (SAIDI)	80.83 orë/vit	68.9 orë/vit	51.84 orë/vit
	Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit (SAIFI)	58.27	49	40.86
	Pjesëmarrja e shpenzimeve të energjisë në të ardhurat e përgjithshme të ekonomive familjare (%)	12.46%	10%	8%
	Humbjet komerciale (%)	3.38%	2.5%	0%
	Humbjet teknike (%)	15.1%	12%	9%
	Humbjet në rrjetin e transmetimit (%) (2021)	1.75%	1.75%	1.75%
2.2	Përdorimi i kapaciteteve nominale interkonektive (%)	Drejtimit i eksportit: 22-24% Drejtimit i importit: 24-26%	40%	70% (targeti minimal i BE-së)
	Integrimi i tregut me tregjet pan-evropiane të energjisë elektrike	Jo në vend	Integrimi i tregut me Shqipërinë	Anëtarësimi në zonën e tregut Pan-Evropian
2.3	Gjatësia e rrjetit hekurudhor të modernizuar (km)	0	149.1	365.1
	Gjatësia e rrjetit rrugor të modernizuar (km)	249	337	471
	Numri i pasagjerve në transportin hekurudhor	60.4 mijë (2021)	400 mijë	5 milionë
	Pjesëmarrja e transportit dhe magazinimit në VShB (%)	4.6%	5.5%	7%
2.4	Eksportet e shërbimeve të transportit (mil. euro)	67.11	>70%	>150%

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
2.5	Numri i aksidenteve të trafikut me të lënduar (për mil. banorë)	4,026	<80%	<90%
	Aksidentet e trafikut me viktima (për mil. banorë)	43	<20%	<30%
2.6	Amvisëritë e mbuluara nga rrjeti me shpejtësi 1Gbps (%)	15%	30%	100%
	Mbulimi nga rrjeti 5G	0%	50%	100%
	Konektiviteti ndërkombëtar (Gbps)	375	>75%	>150%

Strategjitë sektoriale

Për zbatimin e këtij qëllimi zhvillimor do zhvillohet korniza strategjike sektoriale, e cila parasheh veprime konkrete për zhvillimin e infrastrukturës:

- Strategjia e energjisë;
- Strategjia e transportit;
- Strategjia për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Agjendat horizontale

Ky qëllim zhvillimor është i ndërlidhur edhe me agjendën digjitale dhe agjendën e gjelbër. Investimet në infrastrukturën e komunikimit do përshpejtojnë kalimin në ekonominë dhe shoqërinë digjitale. Gjithashtu, investimet në infrastrukturën e transportit dhe energjisë, do bëhen duke respektuar standardet e ndikimit mjedisor.

Integrimi evropian

Përmbushja e qëllimit ndikon drejtpërdrejtë edhe në realizimin e reformave për integrim evropian, veçanërisht detyrimet për politikat e transportit (Kapitulli 14), energjinë (Kapitulli 15), shoqëria e informacionit dhe mediat (Kapitulli 10) dhe integrimi në rrjetet trans-evropiane (Kapitulli 21).

Përmbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikojë drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, veçanërisht objektivit 7, 9 dhe 11.



> QËLLIMI 3

Mjedis i pastër dhe shfrytëzim më i mirë i burimeve natyrore

Me rritje të veprimtarisë ekonomike, shpesh herë rritet edhe kërkesa për shfrytëzim të kapaciteteve të kufizuara natyrore. Mjedisi është e mira e përbashkët e një shoqërie dhe kësaj duhet të menaxhohet dhe ruhet me kujdes. Menaxhimi i dobët i mjedisit dhe eksploatimi eventual i burimeve natyrore, prodhon pasoja të theksuara në siguri dhe cilësi të jetës, si për gjeneratën e tanishme, ashtu edhe për gjeneratat e ardhshme.

SKZH 2030 synon të sigurojë shtrirje universale të mbledhjes së mbeturinave dhe menaxhim më të qëndrueshëm, duke përfshirë klasifikimin dhe ripërtëritjen e tyre, deri te krijimi i kapaciteteve të prodhimit të energjisë dhe ngrohjes nga mbeturinat. Do të ndërtohen stacione të transferimit dhe qendra për seleksionim të mbeturinave, si dhe do të mbështeten bizneset për krijimin e infrastrukturës për lloje të ndryshme të mbetjeve.

Kosova synon që deri në vitin 2030 të krijojë dhe mbajë një mjedis të pastër, që në thelb ka parandalimin e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit, si dhe mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi, të gjitha këto në funksion të një jetese më cilësore. Gjithashtu, të vetëdijshëm që vendi ka potencial të burimeve natyrore, do të ketë shfrytëzim më efektiv dhe më të qëndrueshëm të këtij potenciali. Nëpërmjet realizimit të këtij qëllimi zhvillimor, Kosova i bashkohet bashkësisë ndërkombëtar për adresimin e sfidave globale të mjedisit.

Ndër të tjera, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet krijimit të kapaciteteve të reja për grumbullimin e ujit dhe investimeve në rrjetin ekzistues të furnizimit me ujë, duke ulur ndjeshëm humbjet teknike dhe komerciale, si dhe zgjeruar e rrjetin. Do të finalizohet harta zonale në nivel vendi dhe do bëhet hartëzimi i pyjeve sipas funksioneve (ekonomike, ekologjike, shoqërore).


Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 3.1

Emetimet e GHG (mt CO₂ eq.)

Treguesi mat të gjitha gazrat serë të prodhuara në Kosovë dhe i konverton sasitë në ekuivalente të CO₂.

baza:
9.6 mil. ton të CO₂ eq



▲ 2026
<12%

● 2030
<30%

Burimi: AMMK

Treguesi i ndikimit 3.2

Vitet e humbura të jetës në 100,000 banorë që i atribuohen grimcave PM_{2.5}

Treguesi mat të gjitha gazrat serë të prodhuara në Kosovë dhe i konverton sasitë në ekuivalente të CO₂.

baza:
2,458

2026
1,846

2030
1,229

Burimi: AEM

Treguesi i ndikimit 3.3

Produktiviteti i resurseve

Shkëputja mes përdorimit të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike.

baza:
2,4582026
1,8462030
1,229

Burimi: ASK

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet përmes këtyre qëllimeve strategjike:

- 3.1. Menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe rritja e qarkullimit të burimeve;
- 3.2. Përmirësimi i qasjes në ujë dhe kanalizim, dhe zvogëlimi i ndotjes së ujërave;
- 3.3. Rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në miksin energjetik;
- 3.4. Përmirësimi i efijencës së energjisë;
- 3.5. Përmirësimi i disponueshmërisë së ujit dhe efijencës;
- 3.6. Promovimi i mobilitetit digjital dhe të qëndrueshëm;
- 3.7. Menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe mbrojtja e biodiversitetit;
- 3.8. Planifikimi i përgjegjshëm dhe zhvillimi i integruar i territorit.

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës së qëllimeve strategjike:

Qs	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
3.1	Mbetjet e ngurta komunale të grumbulluara dhe menaxhuara në objekte të kontrolluara nga totali i mbetjeve komunale (%)	83.9%	90%	99%
	Familjet me qasje në sistemin e ndarjes së mbeturinave në burim (%)	9.64%	15%	30%
	Mbetjet e ngurta komunale të ripërtëritshme nga totali i mbetjeve komunale të krijuara (%)	2-5% (Vlerësim i përafërt)	12%	30%
3.2	Popullsia me qasje në sistemet publike të ujit (%)	78%	92%	95%
	Popullsia me qasje në sistemet publike të kanalizimit (%)	65%	75%	85%
	Popullsia me qasje në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza (%)	3%	45%	60%

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
3.3	Pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme në konsumin bruto final të energjisë (%)	24.4%	27.5%	32%
	Pjesëmarrja e BRE-ve (%) në prodhimin e energjisë elektrike	6.3%	18%	34%
3.4	Kursimet e energjisë (Ktoe)	2.7 Ktoe	66.6 Ktoe	217.6 Ktoe
	Intensiteti i energjisë (toe/mEUR)	467.2	250 (320)	150 (220)
3.5	Kapaciteti total i depozitave të ujit (mil. m ³)	559	575	719
	Humbjet e ujit në sistemet publike të furnizimit (%)	55%	48%	42%
	Intensiteti i përdorimit të ujit (VSHB/m ³ ujë çdo vit)	16.2	25	30
3.6	Sistemi i transportit inteligjent (%)	0%	40%	100%
	Transporti ndërkufitar i mallrave përmes hekurudhës (%)	1.9%	12%	35%
	Emetimet e GHG në transport (ekuivalenti i Mt CO ₂)	1,337	<12%	<30%
3.7	Sipërfaqja e rryllëzuar (km ²)	400 ha	2,000 ha	6,000 ha
	Prerjet ilegale të pyjeve	Publike:40% Private: 30%	Publike: 35% Private: 25%	Publike: 20% Private: 15%
	Numri i specieve të kërcënuara	90	45	0
3.8	Harta zonale	Jo		

Strategjitë sektoriale

Zbatimi i këtij qëllimi zhvillimor do të arrihet nëpërmjet zbatimit të strategjive sektoriale:

- Strategjia për mbrojtjen e mjedisit;
- Strategjia për menaxhimin e integruar të mbeturinave;
- Strategjia e ujërave.

Agjendat horizontale

Ky qëllim zhvillimor është i ndërlidhur ngushtë me agjendën e gjelbër. Për të përmbushur qëllimet e agjendës së gjithëpërfshirjes, do t'i kushtohet rëndësi qasjes së të gjithë qytetarëve pa dallim në sistemin publik të furnizimit me ujë dhe qasjes në rrjetin publik të ujërave të zeza. Ulja e emetimit të gazrave serrë do të bëhet, ndër të tjera, duke përmbushur agjendën digjitale, sidomos në sektorin e transportit dhe në shërbimet publike.

Integrimi evropian

Qëllimi zhvillimor për një mjedis të pastër dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore ndikon edhe në arritjen e qëllimeve të agjendës së integrimit evropian, veçanërisht kapitullin 14 të MSA, që ka të bëjë me politikat e transportit, energjinë (Kapitulli 15) dhe mjedisin (Kapitulli 27).

Përmbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivave 6, 7, 8, 11, 13 dhe 15.



Vizioni për Kosovën

2030



Zhvillimi i barabartë njerëzor

4 qëllime zhvillimore

17 tregues të ndikimit

18 qëllime strategjike

49 tregues të rezultatit



Sektorët

12. Kultura dhe sporti

13. Tregu i punës dhe punësimi

14. Kujdesi social

15. Shëndetësia

16. Arsimi dhe shkenca

> QËLLIMI 4

Arsim i qasshëm dhe cilësor

Arsimi cilësor dhe i qasshëm është shtylla kryesore, jo vetëm për zhvillimin e barabartë njerëzor, por edhe si themel i zhvillimit të përgjithshëm të vendit. Reformat e arsimit gjatë dekadave të fundit nuk kanë arritur qëllimin e zhvillimit afatgjatë të sistemit të arsimit, që t'i përgjigjet sfidave të tashme dhe t'i paraprijë sfidave të së ardhmes.

Për t'i tejkaluar sfidat aktuale dhe për të mundësuar arsim cilësor dhe të qasshëm për të gjithë, Kosova synon ndërlidhjen e sistemit arsimor jo vetëm me tregun e brendshëm të punës, por edhe zhvillimin e shkathtësive për integrim në institucionet arsimore dhe tregjet e vendeve të zhvilluara. Për këtë qëllim, do të aplikohet qasje zhvillimore dhe sistematike nga edukimi në fëmijërinë e hershme, deri te arsimi i lartë dhe krijimi i mundësive për arsim gjatë gjithë jetës. Krijimi i një ekonomie inovative dhe konkurruese varet drejtpërdrejt nga zhvillimi i sektorit privat, prandaj synim do jetë eliminimi hendekut të shkathtësive në tregun e punës.

SKZH 2030 mëton që deri më 2030 të rrisë pjesëmarrjen e fëmijëve në edukimin e hershëm (0-5 vjeç) dhe rritjen e numrit të qendrave të kujdesit apo institucioneve parashkollore, gjë që do t'i kontribuojë në ngritjen e numrit të grave të punësuar. SKZH 2030 synon të përmirësojë rezultatet e nxënësve kosovarë në testet ndërkombëtare dhe në uljen e hendekut në mes të viteve të pritura dhe viteve mesatare të shkollimit. Për këtë qëllim, do punohet në vazhdimësi në arritjen e pjesëmarrjes 100% në mësimdhënie të organizuar për nivelet e detyrueshme dhe uljen e braktisjes së shkollimit, me fokus të veçantë tek pakicat kombëtare, popullsinë në zonat rurale dhe grupet e cenueshme dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët mbesin grupi më i cenueshëm në arsim.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 4.1

Rezultatet në PISA

Rezultatet në testimin PISA, të OECD në lexim, matematikë, dhe shkencë. Përmbajtja: kuptimi themelor i materialit; Progresi: mendime më komplekse, siç janë interpretimi dhe analiza; Konteksti: aplikimi i njohurive në situata të jetës reale. Të zbrërthyer sipas gjinisë.

baza:

Total: Leximi: 353.1;
Matematika: 365.9; Shkenca:
364.9; Vajza: Leximi: 366;
Matematika: 364; Shkenca: 368
(2018)

2026

**Rritje për
5%**

2030

**Rritje për
13%**

Burimi: OECD

Treguesi i ndikimit 4.2

HDI: Hendeku në Indeksin e Arsimit

Hendeku në mes të viteve të pritura të shkollimit të fëmijëve në moshën e hyrjes në shkollë dhe viteve mesatare të shkollimit të popullsisë së rritur.

baza:

5.3 vite (13.2 vitet e pritura të shkollimit, 7.9 vitet mesatare të shkollimit) (2019)

2026

2 vite

2030

0 vite

Burimi: Banka Botërore

Treguesi i ndikimit 4.3

Pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin parauniversitar

Pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin parauniversitar (të zbërthyer sipas nivelit të arsimit - fillor, mesëm i ulët, mesëm i lartë, dhe sipas gjinisë).

	baza	2026	2030
Total fillor	100%	100%	100%
Total mesëm i ulët	90.4%	93%	97%
Total mesëm i lartë	82.5%	87%	92%
Vajza fillor	100%	100%	100%
Vajza mesëm i ulët	90.4%	93%	97%
Vajza mesëm i lartë	83.3%	87%	92%

Burimi: ASK

Treguesi i ndikimit 4.4

Indeksi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme

Indeksi (ECDI 2030) mbulon arritjet kyç të zhvillimit nga fëmijët midis moshës 36 dhe 59 muajsh. Të zbërthyer sipas gjinisë dhe etnisë.

	baza	2026	2030
Total	91.3%	95%	98%
Vajza	92.3%	95%	98%
Rom, Ashkali, Egjiptian	81.8%	87%	91%

Burimi: ASK

Treguesi i ndikimit 4.5

Shkalla e fëmijëve jashtë shkollës

Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës jashtë shkollës janë ata që nuk ndjekin arsimin e fëmijërisë së hershme, arsimin fillor ose të mesëm të ulët. Të zbërthyer sipas gjinisë dhe etnisë.

	baza	2026	2030
Total	2.1%	<1%	<1%
Vajza	1.7%	<1%	<1%
Rom, Ashkali, Egjiptian	13.2%	6%	<4%

Burimi: MASHTI

Treguesi i ndikimit 4.6

Përqindja e fëmijëve të moshës 3 dhe 4 vjeçar të cilët ndjekin edukim në fëmijërinë e hershme

Përqindja e fëmijëve të moshës 3 dhe 4 vjeçar (36-59 muajsh) të cilët ndjekin edukim në fëmijërinë e hershme.

	baza	2026	2030
Total	15%	20%	30%
Vajza	13.4%	20%	30%
Rom, Ashkali, Egjiptian	7.6%	12%	20%

Burimi: ASK

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet, këtyre qëllimeve strategjike:

- Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukim dhe kujdes cilësor në fëmijërinë e hershme;
- Përmirësimi i qasjes gjithëpërfshirëse dhe digjitalizimit në shërbimet arsimore;
- Harmonizim më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës;
- Cilësi, integritet dhe konkurrueshmëri më të lartë në arsimin e lartë.
- Zhvillimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen së performancës të qëllimeve strategjike:

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
4.1	Përqindja e përfshirjes së fëmijëve ne EFH grup moshat o deri në <6	19.5% (2020/2021)	32.0%	40.0%
	Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në nivelin parafillor	88% (2020/2021)	100%	100%
	Përqindja e fëmijëve që vijnë në klasën e parë të shkollës fillore të cilët kanë ndjekur arsimin parafillor vitin e kaluar	Total: 87.7% Vajza: 88.2% Rom, Ashkali, Egjiptian: 73% (2019/2020)	Total: 95% Vajza: 95% Rom, Ashkali, Egjiptian: 85%	Total: 99% Vajza: 99% Rom, Ashkali, Egjiptian: 90%
4.2	Përqindja e mësimdhënësve që marrin pjesë në programe të zhvillimit profesional	25% (2019/2020)	45%	70%
	Përqindja e mësimdhënësve, nxënësve, dhe personelit arsimor me kompetenca digjitale	N/A	Mësimdhënës: 80% Personel arsimor: 80% Nxënës: 70%	Mësimdhënës: 95% Personel arsimor: 95% Nxënës: 95%
	Përqindja e shkollave me qasje në internet dhe kompjuter	Qasja në internet: Qasja në kompjutera	80%	Platforma digjitale e arsimit: është ndërtuar, është e populluar me të dhëna digjitale, ofron shërbime digjitale mundëson procese automatike digjitale.
	Përqindja e braktisjes në arsimin e obligueshëm dhe të mesëm të lartë	Arsimi i obligueshëm: 0.1% Arsimi i mesëm i lartë: 1.2%	Arsimi i obligueshëm: nën 0.1% Arsimi i mesëm i lartë: 0.4%	Arsimi i obligueshëm: nën 0.1% Arsimi i mesëm i lartë: 0.8%
	Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollim të obligueshëm dhe të mesëm të lartë*	Arsim i obligueshëm: 44% Arsim i mesëm i lartë: 25%	Arsim i obligueshëm: 65% Arsim i mesëm i lartë: 35%	Arsim i obligueshëm: 80% Arsim i mesëm i lartë: 50%
	Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollim të obligueshëm dhe të mesëm të lartë*	Arsim i obligueshëm: 44% Arsim i mesëm i lartë: 25%	Arsim i obligueshëm: 65% Arsim i mesëm i lartë: 35%	Arsim i obligueshëm: 80% Arsim i mesëm i lartë: 50%

Q.S	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
4.3	Përqindja e sistemimit të të diplomuarve nga IAAP, në profesionet përkatëse dhe në arsimin e lartë	N/A	60%	85%
4.4	Shkalla e punësimit pas përfundimit të arsimit të lartë (studime gjurmuese) (%)	N/A	60%	85%
	Numri i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore	N/A	Së paku 5 në vit	Së paku 8 në vit
4.5	a) % e shpenzimeve të PBB në hulumtim dhe zhvillim.	Mungojnë të dhënat.		
	b) Indeksi i revistave hulumtuese të vendit në platformën Scopus dhe Web of Science	Revistat shkencore të Kosovës nuk janë pjesë e Scopus dhe Web of Science.		

Strategjitë sektoriale

Për zbrërthimin dhe zbatimin e qëllimit zhvillimor për ofrimin e arsimit cilësor dhe të qasshëm do hartohet strategjia sektoriale:

- Strategjia e Arsimit 2022-2026.

Agjendat horizontale

Qëllimi zhvillimor është i ndërlidhur edhe me agjendat horizontale. Do të investohet në digitalizimin e mëtejshëm të sistemit arsimor, të tillë që platformat digjitale mësimore të kenë shtrirje në të gjitha shkollat në Kosovë dhe nxënësit të kenë qasje dhe të përdorin materialet mësimore digjitale. Në këtë aspekt, do hartohen programe të zhvillimit profesional për mësimdhënësit dhe do sigurohet që këto programe ofrojnë mundësi për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, rrisin përdorimin e teknologjisë digjitale, dhe përmirësojnë qasjen edukative ndaj mësimdhënies. Në të gjitha nivelet e arsimit do të përmirësohet mbledhja e të dhënave, veçanërisht të dhënave të zbrërthyer sipas vendbanimit, gjinisë, etnisë, moshës, aftësive të kufizuara, në mënyrë që mbikëqyrja e zbatimit të planeve aktuale, por edhe zhvillimi i politikave dhe veprimeve në të ardhmen, të mund të adresojnë pabarazitë dhe të mundësojë arsim të qasshëm për të gjithë.

Integrimi evropian

Arsimi cilësor është një ndër kriteret e agjendës së integritimeve evropiane, prandaj përbushja e këtij qëllimi zhvillimor do të ndikoj drejtpërdrejtë në zbatimin e MSA, konkretisht obligimet që dalin në politikat e arsimit, kulturës, shkencës dhe punësimit (kapitujt 19, 25 dhe 26).

Përbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivit 4, 5, 8 dhe 10.



> QËLLIMI 5

Punësim i lartë, i dinjitetshëm dhe gjithëpërfshirës

Për adresimin e sfidave në tregun e punës, SKZH 2030 ka për synim që, deri më 2030, të rrisë nivelin e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nivelin e punësimit, me theks të veçantë të rinia, gratë dhe grupet tjera të cenueshme. SKZH 2030 synon që nëpërmjet përmirësimit të bashkëpunimit të sektorit privat me sektorin e arsimit, të zvogëlohet hendeku i shkathtësive në tregun e punës dhe të krijohen mekanizma për planifikim afatgjatë të orientimit të tregut të punës. Përveç kësaj, do kryhet analiza e tregut të punës, me fokus në parashikimin e shkathtësive, me qëllim të adresimit të hendekut të shkathtësive dhe për parandalimin e këtij hendeku në të ardhmen. Ndër të tjera, do të mundësohet punësim i dinjitetshëm, duke fuqizuar organet mbikëqyrëse, duke rritur mbikëqyrjen e tregut të punës dhe duke ofruar stimuj për formalizimin e punësimit.

Për më tepër, mungesa e të dhënave për lëndime, sëmundje dhe vdekje në punë, do të adresohen nëpërmjet mbledhjes së vazhdueshme dhe cilësore të të dhënave, për të siguruar që ato e informojnë punën e institucioneve në adresimin e legjislacionit përkatës. Për rritjen e punësimit të grave, do të shqyrtohet baza ligjore sa i përket barrës së pushimit të lehonisë, atësisë dhe pushimit prindëror, duke rritur barrën e shtetit për kompensimin e grave gjatë pushimit të lindjes dhe duke rregulluar pushimin e atësisë.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 5.1

Shkalla e punësimit

Përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që është e punësuar.

	baza	2026	2030
Total	20%	40%	50%
Gratë	16%	25%	35%
Të rinjtë	11.9%	25%	35%

Burimi: ASK

Treguesi i ndikimit 5.2

Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Përqindja e popullsisë në moshë pune, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës.


	baza	2026	2030
Total	39.5%	45%	55%
Gratë	22.7%	40%	50%
Të rinjtë	23.4%	43%	55%

Burimi: ASK

Treguesi i ndikimit 5.3

Shkalla e informalitetit (%)

Punësimi jo formal në punësimin total.


baza:
35%▲ 2026
20%● 2030
10%

Burimi: ASK

Treguesi i ndikimit 5.4

Rastet e sëmundjeve dhe vdekjeve në vendin e punës

Numri i rasteve të sëmundjeve të punës dhe vdekjeve në vendin e punës, brenda vitit.

baza:
1882026
02030
0

Burimi: IP

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet këtyre qëllimeve strategjike:

- Zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave dhe ngushtimi i hendekut në tregun e punës;
- Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës;
- Përmirësimi i kushteve të punës.

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës të qëllimeve strategjike:

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
5.1	Mosperputhja vertikale e shkathtësive	42.2% (2020)	36%	36%
	Mosperputhja horizontale e shkathtësive	74,9% (2019)	65%	50%
	Përqindja e profileve të arsimit profesional që mundësojnë mësimin praktik.	N/A	80%	98%
5.2	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore të ndare sipas gjinisë	Total:37.7% Gratë:20.6% (TM2 2021)	Total: 50% Gratë: 45%	Total: 60% Gratë: 55%
	Shkalla NEET	Total:32.5% Gra:32.5% (TM2 2021)	Total: 20% Gra: 20%	Total: 15% Gra: 15%
5.3	Përqindja e kontratave të përhershme	42.8 % (2021)	63%	65%
	Varfëria në punë	15.2% (2020)	10%	Më pak se 10%

Strategjitë sektoriale

Në mënyrë që të arrihet qëllimi për një treg të punës gjithëpërfshirës dhe rritja e punësimit të denjë, do hartohet strategjia sektoriale:

- Strategjia e tregut të punës dhe punësimit.

Agjendat horizontale

Qëllimi zhvillimor është i ndërlidhur edhe me zotimet e Kosovës për sigurimin e gjithëpërfshirjes në tregun e punës, rritjen e punësimit në sektorët e qëndrueshëm ekonomik dhe me politikat e migracionit dhe diasporës.

Integrimi evropian

Qëllimi zhvillimor për një treg të punës gjithëpërfshirës është i lidhur edhe me agjendën e integrimit evropian, veçanërisht me politikat e përbashkëta sociale dhe të punësimit (Kapitulli 19).

Përbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivit 8.



> QËLLIMI 6

Shëndet dhe mirëqenie e përmirësuar

Për tejkalimin e sfidave në sektorin e shëndetësisë, të identifikuar nëpërmjet analizës së gjendjes aktuale, një nga qëllimet e SKZH 2030 është përmirësimi i kualitetit dhe qasjes në shërbime shëndetësore dhe promovimi i jetës së shëndetshme, me synimin e rritjes së jetëgjatësisë së popullsisë dhe uljes së vdekshmërisë, veçanërisht uljes së vdekshmërisë së foshnjave dhe nënave.

Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të informimit shëndetësor, së bashku me skemën e sigurimit shëndetësor publik, do të shërbejnë si mjete për përmirësimin e qasjes në shërbime të shëndetësisë dhe për rritjen e kualitetit të këtyre shërbimeve. Nëpërmjet bashkëpunimit në mes ministrive dhe institucionet e arsimit të lartë, do të zhvillohet plani i veprimit për parandalimin e sfidave që do të shfaqen në sistemin shëndetësor, si rezultat i ikjes së trurit në këtë sektor. Me qëllim të zbulimit të hershëm dhe parandalimit të sëmundjeve më të rënda, do të zhvillohet dhe zgjerohet programi i vizitave në shtëpi.

Me qëllim të rritjes së gjasave për parandalimin e sëmundjeve dhe vdekshmërisë së parakohshme, do të investohet në programe për jetesë të shëndetshme në kuadër të rekreacionit, si dhe do të prioritetizohet mbledhja e të dhënave dhe identifikimi i mundësive për rritjen e jetesës së shëndetshme.

Po ashtu, SKZH 2030 ka për qëllim përmirësimin e targetimit të skemave sociale që të ulen shkallën e varfërisë, në mënyrë që skemat e mirëqenies të shërbejnë për të tejkaluar varfërinë dhe nevojën për mbështetje në skema sociale. Duke rishikuar dhe ri dizajnuar sistemin e skemave sociale, do të sigurohet që skemat sociale dhe transferet të targetojnë ata që kanë më së shumti nevojë. Po ashtu, do të zhvillohet korniza legjislative që garanton strehim të denjë për të gjithë, për mundësimin e qasjes në strehim publik dhe të përballeshëm për familjet në nevojë.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 6.1

Indeksi i jetëgjatësisë në HDI

Numri i viteve që do të jetonte një foshnjë e porsalindur nëse modelet mbizotëruese të vdekshmërisë në kohën e lindjes do të qëndronin të njëjta gjatë gjithë jetës.

baza		
Total	Burra	Gra
71	69	74
2026		2030
76		79

Burimi: Banka Botërore

Treguesi i ndikimit 6.2

Pjesa e popullsisë që raporton formë të privimit material (%)

Përqindja e anëtarëve të familjes që jetojnë në ekonomi familjare të privuara nga tre prej nëntë dimensioneve të të mirave materiale.


	baza	2026	2030
Total	44.1%	30%	20%
Rom, Ashkali, Egjiptian	86.2%	60%	40%

Burimi: ASK

Treguesi i ndikimit 6.3

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (%)

Probabiliteti i vdekshmërisë gjatë vitit të parë të lindjes.

baza:
16%▲ 2026
10%● 2030
5%

Burimi: ASK

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet, këtyre qëllimeve strategjike:

- 6.1. Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbime shëndetësore;
- 6.2. Mënyrë më e shëndetshme e jetesës;
- 6.3. Përmirësimi i targetimit dhe shpërndarjes së mbrojtjes sociale;
- 6.4. Qasje më e mirë në shërbime sociale;
- 6.5. Qasje në strehim të denjë, të përballueshëm, dhe cilësorë;
- 6.6. Qasje në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt dhe me vlera ushqyese për të përmbushur nevojat dietale për jetë të shëndetshme

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës të qëllimeve strategjike:

Q.S	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
6.1	Shkalla e shfrytëzueshmërisë së shtretërve spitalor dhe klinik	2.5 (2020) 57%	2.5 , 70%	2.5 , 85%
	Përqindja e popullsisë që nuk ka qasje në shërbime shëndetësore	18%	10%	Më pak se 1%
	Përqindja e popullsisë që mbulohet nga sigurimet shëndetësore (të zbërthyer sipas publik/privat, moshës, urban/rural)	6.8% (2019)	50%	Së paku 75%
	Përqindja e komunave që implementojnë programin e shërbimit të vizitave në shtëpi	66% 25 nga 38 komuna (2022)	87% 33 nga 38 komuna	100% 38 nga 38 komuna
	Numri i mjekëve, infermierëve dhe personelit shëndetësor për 1,000 banorë	1.2 mjekë. Në vitin 2020 ka qenë: 1.5 për mjekë dhe 4 për infermierë (IKSHPK) 2012	2 mjekë	2.5 mjekë

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
6.2	Koha aktive për person (TUS) (min/ditë)	24min/ditë (2016)	30min/ditë	45min/ditë
	Mbulueshmëria e plotë e imunizimit për moshën 24-35 muaj	Totali: 72.5% Vajza: 75.8% Rom, Ashkali, Egjiptian: 37.5% (2019)	Totali: 85% Vajza: 85% Rom, Ashkali, Egjiptian: 45%	Totali: 95% Vajza: 95% Rom, Ashkali, Egjiptian: 60%
6.3	Përqindja e popullsisë që mbulohet nga transferet sociale	50.6% e totalit të popullsisë (2019)	Së paku 80% e atyre në nevojë	Së paku 90% e atyre në nevojë
	Shkalla e varfërisë, me theks të veçantë tek varfëria e grupeve të cënueshme, fëmijëve, zonave rurale/urbane, minoriteteve etnike.	Totali: 29.7% Fëmijë: 23% (2019)	Totali: 20% Fëmijë: 18% (2019)	Totali: 10% Fëmijë: 8% (2019)
6.4	Seksioni Regjimi i Mirëqenies brenda Indeksit të Transformimit Ekonomik të BTI-së	5.5 (2019)	7.5	9
	Shpenzimet e kujdesit social për kokë banori	200% e pagës minimale	250% e pagës minimale	300% e pagës minimale
6.5	Përqindja e popullsisë që raportojnë ndonjë nivel të privimit të strehimit	25.5% (2019)	15%	5%
6.6	Disponueshmëria e ushqimit, që përfshin diversitetin e kulturave në tokë të punueshme dhe tokën e punueshme si përqindje e tokës totale	Toka e punueshme: 48.3% Drithëra: 66.2% Bimë foragjere: 19.9% Perime: 6.8% Bishtajore: 1.6% Kultura tjera: 7.1% Tokë djerrinë: 3.5%	Toka e punueshme: 50% Drithëra: 64% Bimë foragjere: 15% Perime: 12% Kultura tjera: 7% Tokë djerrinë: 2%	Toka e punueshme: 55% Drithëra: 65% Bimë foragjere: 15% Perime: 12% Kultura tjera: 7% Tokë djerrinë: 1%
	Përqindja e shpenzimeve ushqimore ndaj totalit të shpenzimeve të familjes	40%	35%	27%
	Përqindja e pesticideve dhe plehrave tjera në shpenzimet e ekonomive bujqësore	Plehra minerale 18.6% Plehra organike 0.9% Kemikale - pesticide (herbicide, insekticide, fungicide, etj.) 4.7%	Plehra minerale 20% Plehra organike 3% Kemikale - pesticide (herbicide, insekticide, fungicide, etj.) 2%	Plehra minerale 20% Plehra organike 5% Kemikale - pesticide (herbicide, insekticide, fungicide, etj.) 1%

Strategjitë sektoriale

Në mënyrë që të arrihet qëllimi strategjik i shëndetësisë dhe mirëqenies së përmirësuar, do zhvillohen strategjitë sektoriale:

- Strategjia e shëndetësisë;
- Strategjia për mbrojtje sociale.

Agjendat horizontale

Parimet e gjithëpërfshirjes do të përcjellin secilin veprim të reformave në shëndetësi dhe në programet sociale. Për këtë qëllim, do t'i kushtohet kujdes më i madh ofrimit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve të marginalizuara, tek të cilët shkalla e imunizimit dhe jetëgjatësisë është më e ulët, ndërsa sëmundjet dhe vdekshmëria më e lartë. Nëpërmjet politikave për ndaljen e migrimit dhe angazhimin e diasporës, do të adresohen arsyet e largimit të profesionistëve shëndetësorë dhe gradualisht kthimin e tyre dhe profesionistëve nga diaspora në institucionet shëndetësore të Kosovës.

Integrimi evropian

Qëllimi zhvillimor është i ndërlidhur edhe me MSA, politikat e përbashkëta sociale (Kapitulli 19) dhe mbrojtjen e shëndetit (Kapitulli 28).

Përbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivat 1, 3 dhe 8.



> QËLLIMI 7

Kulturë kreative dhe shoqëri aktive

Kultura dhe sporti kanë kontribuar në promovimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe SKZH 2030 do t'u kushtoj vëmendje më të madhe.

SKZH 2030 synon të prioritetizojë mbrojtjen, ruajtjen, dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, në linjë me strategjinë për këtë sektor. Duke pasur parasysh nivelin e talentit në sport dhe kulturë, SKZH 2030 synon fuqizimin e kulturës dhe sportit në bashkësi, investimin në rritjen e kapitalit njerëzor, si dhe investime të fokusuara në përmirësimin e infrastrukturës së sportit dhe kulturës. Përveç kësaj, SKZH 2030 parasheh edhe rritjen e promovimit të turizmit të qëndrueshëm sportiv dhe kulturor në tërë territorin e Kosovës.

Me qëllim të informimit të investimeve dhe planifikimeve të politikave që kanë për qëllim zhvillimin e këtyre sektorëve, do të bëhet mbledhja sistematike e të dhënave në kulturë, e posaçërisht në sport. Gjithashtu, do të krijohet ndërlidhja e jetës së shëndetshme dhe zhvillimit të sportit në nivel shkollor, si dhe sportit amator dhe rekreativ. Sa i përket trashëgimisë kulturore, do t'i jepet prioritet zbatimit të Strategjisë për trashëgimi kulturore.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 7.1

Menaxhimi i qëndrueshëm i trashëgimisë kulturore

Paraqet listën kontrolluese lidhur me kornizën e menaxhimit të qëndrueshëm për të mbrojtur dhe menaxhuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore, praktikat, njohuritë dhe artefaktet historike të luajtshme.

baza:
N/A

2026
N/A

2030
N/A

Burimi: UNESCO

Treguesi i ndikimit 7.2

Kultura ne BPV

Ky tregues synon të vlerësojë kontributin e përgjithshëm të sektorit të kulturës në ekonomi në një territor të caktuar.

baza:
N/A

2026
N/A

2030
N/A


Burimi: UNESCO

Treguesi i ndikimit 7.3

Pjesëmarrja aktive në sport

Pjesa e popullsisë të angazhuar aktivisht në aktivitete sportive.

baza:
1.4%



▲ 2026
5%

● 2030
10%


Burimi: MKRS

Treguesi i ndikimit 7.4

% e kontributit të sportit në BPV vjetor

% e kontributit të sportit në BPV vjetor. Në mungesë të të dhënave të zëbërthyer për kontributin e sportit në BPV, ky tregues është llogaritur duke mbledhur të gjitha shpenzimet e qytetarëve, klubeve dhe federatave sportive, nivelin lokal dhe qendror të qeverisjes, dhe duke zbritur subvencionet e Qeverisë.

baza:
0.58%



▲ 2026
1%

● 2030
2%

Burimi: MKRS

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet këtyre qëllimeve strategjike:

- 7.1. Art dhe kulturë për mirëqenie dhe zhvillim;
- 7.2. Forcimi i mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore;
- 7.3. Shoqëri aktive dhe e shëndetshme përmes aktivitetit sportiv;
- 7.4. Fuqizimi i të rinjëve në jetën ekonomike dhe sociale të vendit;
- 7.5. Konsolidimi i imazhit shtetëror përmes artit dhe sportit;
- 7.6. Turizimi sportiv dhe kulturor

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës të qëllimeve strategjike:

Q.S	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
7.1	Numri i institucioneve qendrore të kulturës me autonomi financiare, qëndrueshmëri institucionale dhe program kualitativ	0 (2022)	5	9
	Numri i organizatave të shoqërisë civile të profilizuara në kulturë me status të definuar dhe qëndrueshmëri financiare	37 (2022)	40	42
	Numri i prodhimeve dhe bashkëprodhimeve kinematografike dhe audiovizuale të kualifikuar në kategoritë A dhe B të festivaleve dhe eventeve të tjera ndërkombëtare, sipas vendit të realizimit	11 (2022)	54	124
	Numri i mallërave pirate në raport me numrin e aksioneve në treg nga taskforca me qëllim të luftimit të piraterisë	200 (2022)	170	130
	Numri mesatar i lexuesve për ditë	150 (2022)	300	500
7.2	Numri i aseteve të restauruara dhe të funksionalizuara të trashëgimisë kulturore	25 (2021)	33	50

Qs	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
	Numri i Zonave të Mbrojtura të integruara në nivel të Planifikimit Hapësinor	1 (2021)	5	10
	Numri i institucioneve qendrore dhe rajonale të trashëgimisë kulturore me autonomi financiare, qëndrueshmëri institucionale dhe kuadro profesionale	0 (2021)	4	8
	Numri i institucioneve të arkivit me sistem të mirëfillt dixhital sipas standardeve ndërkombëtare, të qasshme për publikun	0	2	5
7.3.	Numri i sporteve me rezultate kulminante në garat ndërkombëtare sportive	6 (2022)	8	10
	% e popullatës jo aktive në aktivitet fizik	48% (2022)	45%	35%
	Numri i sporteve të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në ambient të sigurtë dhe me integritet	4 (2022)	53	60
7.4	Rritja e numrit të mekanizmave përfaqësues aktiv në sektorin rinor dhe të fuqizuar në vendimmarrje të nivelit lokal dhe qendror	80 (2022)	120	140
	Ulja e përqindjes së të rinjve NEET duke i përfshirë në edukim joformal	30% (2022)	22%	14%
7.5	Numri i prezantimeve të institucioneve kulturore dhe artistëve vendor në vendet e huaja	70 (2022)	400	775
	Numri i aktiviteteve sportive në të cilat reprezentohet Kosova përmes federatave sportive, klubeve dhe sportistëve / Numri i artikujve të mediave ndërkombëtare për sportin kosovar	820+ (vetëm për periudhën 1Korrik-31Gusht 2021)	3,820	10,020
7.6	Kontributi i kulturës dhe sportit në BPV			

Strategjitë sektoriale

Në mënyrë që të arrihet ky qëllim zhvillimor, do të zhvillohen strategjitë sektoriale:

- Strategjia e Kulturës;
- Strategjia e Sportit.

Agjendat horizontale

SKZH 2030 synon ruajtjen dhe promovimin e kulturës së të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë, fokus më të madh në përfshirjen e vajzave dhe grave në aktivitetet sportive, si dhe identifikimin dhe përfshirjen e talentëve nga të gjitha komunitetet etnike.

Përbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivit 4.



Vizioni për Kosovën

2030



Sigurria dhe sundimi i ligjit

2 qëllime zhvillimore

5 tregues të ndikimit

7 qëllime strategjike

38 tregues të rezultatit



Sektorët

04. Mbrojtja dhe siguria

05. Siguria publike

06. Drejtësia

> QËLLIMI 8

Gatishmëri e lartë për paqe dhe siguri

Kosova ka shënuar përparime në fushën e mbrojtjes duke forcuar, Forcën e Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me partneret strategjik dhe NATO-n. Në këtë drejtim janë marrë hapa për rritjen e kapaciteteve për sigurinë kombëtare. Megjithkëtë, Kosova vazhdon të përballet me sfida lidhur me zhvillimin e kapaciteteve të mjaftuashme të mbrojtjes.

Për adresimin e këtyre sfidave, SKZH 2030 fokusohet në rritjen e gatishmërisë për përmbushjen e misionit kushtetues të FSK-së. Ky qëllim zhvillimor përfshinë edhe forcimin dhe shtimin e kapaciteteve ushtarake për t'u përballur me kërcënimet e jashtme, përfshirë ato hibride. Për këtë qëllim, do të vazhdojë transformimi i FSK-së në ushtri, sipas planit të përcaktuar, do të rritet buxheti për mbrojtje sipas nevojave për mbrojtje të Republikës së Kosovës dhe standardeve të NATO, si dhe do të bëhet zhvillimi i kapaciteteve kibernetike dhe atyre për t'u përballur me kërcënimet e jashtme.

Gjithashtu, ky qëllim zhvillimor përfshinë përpjekjet e Kosovës për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizimit, me synim primar rritjen e sigurisë të të gjithë qytetarëve. Për luftimin e krimit dhe korrupsionit, ndërhyrjet do të fokusohen në përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë nëpërmjet vetingut dhe në përmirësimin e kapaciteteve hetuese, përfshirë ato financiare. Gjithashtu, do të shtohen përpjekjet për forcimin e kapacitetit për policim të bazuar në inteligjencë dhe do të forcohet struktura institucionale në këtë drejtim. Ndër të tjera, do të shtohen përpjekjet për zbatimin e legjislacionit kundër krimit të organizuar, posaçërisht sa i përket konfiskimit final të aseteve si dhe hetimin e shpërlarjes së parave.

Për më tepër, do të shtohen përpjekjet në zbatimin e kornizës strategjike dhe ligjore në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe trafikut të drogës.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 8.1

Siguria (1-5 pikë, vlera më e ulët më mirë)

Vlerëson sigurinë e vendit duke u fokusuar në nivelin e krimit, aktivitetet terroriste, demonstratimet e dhunshme, marrëdhëniet me vendet fqinje, etj.

baza:
2/5

2026
<2

2030
<1.5

Burimi: Indeksi Global për Paqe

Treguesi i ndikimit 8.2

Vlerësimi i KE per Kapitullin 24

Paraqet vlerësimin e KE për progresin e Kosovës në Drejtësi, Liri dhe Siguri.

baza:
1.5/5

2026
>2

2030
>3

Burimi: KE

Treguesi i ndikimit 8.3

Popullsia që raporton vepra penale, dhunë apo vandalizëm (%)

Paraqet përqindjen e veprave penale të raportuara për një vit.

 baza:
1.5/5

 2026
>2

 2030
>3

Burimi: Eurostat

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet këtyre qëllimeve strategjike:

- 8.1. Fuqizimi i kapaciteteve për mbrojtje dhe siguri në bashkëpunim me partnerët Euro-Atlantik;
- 8.2. Gatishmëri e lartë për emergjenca dhe reagim;
- 8.3. Luftimi i krimit dhe korrupsionit;
- 8.4. Siguri e lartë në bashkësi.

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës të qëllimeve strategjike:

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
8.1	Personeli ushtarak (vlera më e ulët më mirë)	1/5 (vlera më e ulët më mirë)	1/5	1/5
	Buxheti për mbrojtje si % e BPV	1.3%	1.5%	2%
	Importi i armëve	1/5	1	1
	Indeksi i integritetit në mbrojtje	D Band (i lartë)	C	B
	Indeksi i Sigurisë Kibernetike Globale	Kosova nuk është e përfshirë në këtë indeks	Mesatarja e BP	Tri vendet e para te BP
	Shpërndarja e informacionit të pavërtetë nga qeveritë e huaja (rangimi në mesin e shteteve të Evropës)	44/45 Në Evropë	35/45	25/45
	Fushatat e qeverive të huaja (rangimi në mesin e shteteve të Evropës)	42/45 Në Evropë	32/45	22/45
8.2	Gatishmëria për reagim	174/360	140/360	120/360

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
8.3	Indeksi për Krim të Organizuar	5.19/10	6/10	7/10
	Perceptimi për korrupsion	39/100	45	50
	Kontrollimi i korrupsionit (percentila 1 deri 100)	48/100	55/100	60/100
	Aktiviteti terrorist	1/5	1	1
	Indeksi Global për Terrorizëm	0.29/9	0	0
8.4	Kontrolli efektiv i krimit	0.87/1	0.9/1	0.9/1
	Prevalenca e përdorimit të narkotikëve tek të rinjtë (%)	4%	Mesatarja e BP	Tri vendet e fundit të BP6
	Aksidentet e trafikut me fatalitet dhe lëndime trupore	43.00	40	35
	Popujt nën kërcenim (mbrojtja e minoriteteve)	9.45	7.5	5
	Indeksi i sigurisë për gra	0.737/2	0.8/2	1/2
	Numri i atyre që jetojnë në skllavëri moderne (në 1000 banorë)	3.97	2.5	1
	Krimi i dhunshëm	3/5	2.5/5	2/5
	Qasja në armë	4/5	3/5	2/5
	Numri i azil-kërkuesve Kosovarë për herë të parë në BE	3229	<2000	<1500
	Numri i imigrantëve	578	-500	-500

Strategjitë sektoriale

Në mënyrë që të arrihet ky qëllim zhvillimor, do të zhvillohen strategjitë sektoriale:

- Strategjia e Sigurisë,
- Strategjia e Mbrojtjes;
- Korniza strategjike për siguri publike, përfshirë atë për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit, trafikimit me droga, trafikimit me qenie njerëzore, si dhe trafikimit me armë.

Strategjitë në fuqi që do vazhdojnë të zbatohen për arritjen e këtij qëllimi të SKZH:

- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna mbi baza gjinore.

Agjendat horizontale

Treguesit e ndikimit dhe rezultateve të këtij qëllimi zhvillimor janë të ndërlidhur edhe me agjendat horizontale, veçanërisht treguesit që kanë të bëjnë me uljen e migrimit, luftimin e krimeve kibernetike dhe ofrimi i sigurisë për të gjithë qytetarët pa dallim. Po ashtu, treguesit janë të ndërlidhur edhe me agjendën e gjithëpërfshirjes, ngase një ndër qëllimet është edhe rritja e pjesëmarrjes së grave dhe grupeve etnike minoritare në institucionet e sigurisë.

Integrimi evropian

Po ashtu, realizimi i këtij qëllimi përafrohet Kosovën me vendet e BE duke përmbushur kriteret e që kanë të bëjnë me sigurinë në komunikacion (Kapitulli 14), rritjen e efektivitetit të gjyqësorit (Kapitulli 23), qasjen në drejtësi dhe garantimin e lirisë e sigurisë (Kapitulli 24), dhe politikatat e sigurisë dhe mbrojtjes (Kapitulli 31).

Përmbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në aritjen e SDG, respektivisht objektivit 16.



> QËLLIMI 9

Drejtësi efektive

Drejtësia efikase, profesionale, e pavarur dhe e qasshme është element kryesor që mundëson zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi. Kosova është zhvilluar në fushën e drejtësisë gjatë viteve të fundit. Gjyqësori është ri organizuar dhe është rritur buxheti për drejtësinë, gjë që ka mundësuar shtimin e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë stafin mbështetës, si dhe janë bërë përpjeke për digjitalizim të procedimit të lëndëve.

Megjithatë, përkundër zhvillimeve, sistemi i drejtësisë ende mbetet shumë i ngadaltë në procedimin e lëndëve, duke shkaktuar vonesa dhe duke penguar qasjen e mirëfilltë në drejtësi. Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, SKZH 2030 synon rritjen e përpjekjeve në sigurimin e drejtësisë efektive. Drejtësia efektive përfshinë përmirësimin e sistemit të drejtësisë në atë mënyrë që avancohet efikasiteti, profesionalizimi, pavarësia dhe llogaridhënia.

Masat kryesore të planifikuara që kontribuojnë në arritjen e këtyre qëllimeve, përfshijnë zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë dhe forcimin e mekanizmave për sigurimin e profesionalizmit dhe pavarësisë në drejtësi. Gjithashtu, planifikohet edhe forcimi i kapaciteteve për të ofruar ndihmë ligjore dhe për mekanizmat e zgjidhjes alternative të kontesteve.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 9.1

Vlerësimi i Raportit të Vendit: Kapitulli 23

Paraqet vlerësimin e KE për gatishmërinë e Kosovës për të adresuar kriteret në gjyqësi.

baza:
1.5/5

2026
>2

2030
>3

Burimi: KE

Treguesi i ndikimit 9.2

Sundimi i ligjit (BTI)

Paraqet vlerësimin se ku gjendet Kosova në sundimin e Ligjit, duke u bazuar në pavarësinë e drejtësisë, ndjekjes dhe të drejtave të njeriut.

baza:
5.5/10

2026
>6

2030
>7

Burimi: Bertelsmann Stiftung

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet këtyre qëllimeve strategjike:

- 9.1. Drejtësi me kohë;
- 9.2. Profesionalizëm, pavarësi dhe llogaridhënie;
- 9.3. Qasje e mirëfilltë në drejtësi.

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës të qëllimeve strategjike:

Q.S	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
9.1	Koha për zgjidhjen e rasteve: Shkalla I	a) 298 dite	a) 144	a) 100
	a. Penale	b) 947 dite	b) 338	b) 300
	b. Civile	c) 419 dite	c) 323	c) 300
	c. Administrative			
	Shkalla e zgjidhjes së rasteve: Shkalla I	a) 110.8%;	a) 100%	a) 150%
	a. Penale	b) 86%	b) 159%	b) 150%
b. Civile	c) 73.8%	c) 171%	c) 150%	
c. Administrative				
9.2	Grumbullimi i rasteve: Shkalla I	a) 42496	<25%	<50%
	a) Penale (të rënda)	b) 45299		
	b) Civile;	c) 6093		
c) Administrative				
	Indeksi i zhvillimit të IT	3.23/10	5/10	7/10
	Mekanizmat e Zgjidhjes Alternative të Kontesteve janë të qasshëm, të paanshëm dhe efektiv	0.61/1	0.7/1	0.8/1
9.3	Sistemi penal është i lirë nga korrupsioni	0.49/1	0.6/1	0.7/1
	Sistemi penal është i paanshëm	0.58/1	0.7/1	0.8/1
	Sistemi penal i lirë nga ndikimi i qeverisë	0.31/1		
	Zyrtarët publikë në gjyqësor nuk përdorin funksionet publike për përfitime private	0.45/1	0.6/1	0.7/1
	Besimi i publikut në gjykata dhe gjyqësor	31%	40%	50%
9.3	Njerëzit kanë qasje dhe mund të përballojnë drejtësinë civile	0.6/1	0.64/1	0.7/1
	Ndihma ligjore	0.6/1	0.7/1	0.8/1
	Të drejtat pronësore për gratë	0.732/1	0.8/1	0.9/1
	Qasja e grave në drejtësi	1.84/4	2	3
	Mekanizmat e Zgjidhjes Alternative të Kontesteve janë të qasshëm, të paanshëm dhe efektiv	0.61/1	0.7/1	0.8/1

Strategjitë sektoriale

Në mënyrë që të arrihet ky qëllim zhvillimor, do të zbatohet strategjia sektoriale:

- Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026.

Agjendat horizontale

Ndërtimi i një sistemi gjyqësor të paanshëm, të qasshëm për të gjithë dhe i cili nuk diskriminon gratë dhe grupet tjera më pak të përfaqësuara, është një ndër elementet e Agjendës për Gjithëpërfshirje. Po ashtu, avancimi i sistemit në përdorimin e teknologjisë informative është në harmoni me qëllimet e Agjendës Digjitale të Kosovës.

Integrimi evropian

Sundimi i ligjit ka qenë një ndër hallkat më të dobëta të qeverisjes, andaj përmbushja e këtij qëllimi do të përfaqësojë Kosovën me venet e BE dhe do ndikoj në harmonizimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e drejtësisë (Kapitujt 23 dhe 24).

Përmbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivat 5 dhe 16.



Vizioni për Kosovën





Qeverisja e mirë

2 qëllime zhvillimore

4 tregues të ndikimit

10 qëllime strategjike

19 tregues të rezultatit



Sektorët

01. Qeveri dhe administratë publike

02. Financat publike

03. Politika e jashtme dhe marrëdhënie ndërkombëtare

> QËLLIMI 10

Qeveri efektive dhe llogaridhënëse

Efektiviteti dhe llogaridhënia në Qeveri është një prej parakushteve të qeverisjes së mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë. Për arritjen e këtij qëllimi zhvillimor, do t'i kushtohet rëndësi hartimit të politikave të bazuara në të dhëna dhe koordinimit të mirëfilltë në mes të institucioneve në hartim dhe zbatim të politikave. Cilësia në ofrimin e shërbimeve publike dhe administrative nuk është e kënaqshme, e në këtë aspekt do t'i kushtohet rëndësi zvogëlimit të barrës administrative për qytetarë dhe biznese, duke përfshirë digjitalizimin e shërbimeve dhe shfaqjes së tyre për aplikim në E-Kosova.

Në aspekt të kapaciteteve të shërbimit civil, SKZH 2030 fokusohet në krijimin e shërbimit civil profesional, të zgjedhur në bazë të meritës dhe me mundësi të barabarta për të gjithë. Në fushën e organizimit të administratës publike, me gjithë ekzistimin e bazës së mirë ligjore në këtë drejtim, gjendja në praktikë kërkon përmirësimin e llogaridhënies menaxheriale dhe racionalizimin e agjencive, me qëllim përmirësimin e nivelit të qeverisjes në administratën publike. Po ashtu, qasja në dokumente publike, gjithëpërfshirja dhe transparenca e punës së Qeverisë do të jetë e plotë.

Arritja e këtij qëllimit zhvillimor është e kushtëzuar nga lidhja konsistente në mes të politikave dhe buxhetit, me qëllim të zbatimit efektiv të politikave publike. Në këtë drejtim, do t'i kushtohet rëndësi rritjes së rolit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në përgatitjen e buxhetit vjetor dhe rritjes së kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të financave publike. Po ashtu, do t'i kushtohet më shumë rëndësi zbatimit të ligjit për barazi gjinore, sidomos sa i përket përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në institucionet publike dhe respektimin e obligimit për buxhetim të përgjegjshëm gjinor. Performanca e ulët dhe menaxhimi i dobët financiar i ndërmarrjeve publike qendrore, është një problem tjetër të cilit do t'i kushtohet rëndësi në vazhdimësi. Po ashtu, performanca e komunave do të rritet nëpërmjet qeverisjes demokratike komunale, menaxhimit komunal dhe ofrimin e shërbimeve nga komuna për qytetarët në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 10.1

Efektiviteti i Qeverisë

Treguesi matë cilësinë e shërbimeve, nivelin e pavarësisë së Sh.C nga politika, 3) cilësia e formulimit dhe zbatimit të politikave dhe kredibiliteti i Qeverisë mbi ato politika;

baza:
-0.32

2026
-0.10

2030
0.10

Burimi: BB

Treguesi i ndikimit 10.2

Besimi në qeveri

Ankete me 117 pyetje dhe të gjeturat prezantohen përmes raportit "Public Opinion Survey".

baza:
26%

2026
35%

2030
50%

Burimi: BB

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet këtyre qëllimeve strategjike:

- 10.1. Rritja e cilësisë në zhvillimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;
- 10.2. Rritja e efektivitetit të shërbimin publik dhe llogaridhënies në administratën publike;
- 10.3. Rritja e performancës së komunave;
- 10.4. Përmirësimi i performancës dhe menaxhimit financiar të ndërmarrjeve publike;
- 10.5. Sigurimi i disiplinës fiskale të qëndrueshme;
- 10.6. Rritja e mëtutjeshme e efikasitetit alokues;
- 10.7. Përmirësimi i mëtejshëm i efikasitetit operacional
- 10.8. Sistem transparent dhe i digjitalizuar i menaxhimit të financave publike;

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës së qëllimeve strategjike:

OS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
10.1	Zhvillimi dhe koordinimi i politikave	2.7	3.5	4.5
	Ofrimi i shërbimeve nga administrata publike	2.5	3.5	4.5
10.2	Shërbim publik dhe menaxhim i burimeve njerëzore	3.5	4	4.5
	Llogaridhënie dhe transparencë ne administratën publike	2.4	3.5	4.5
10.3	Numri i komunave të kualifikuara për Grant të Performancës komunale (GPK) përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës komunale	14	25	38
10.4	Borxhi i NP-ve si % e PBB-së	8%	4%	0%
10.5	Mbajtja e deficitit buxhetor në nivelin <2% të PBB-së	-60%	Mbajtja e deficitit buxhetor në nivelin <2% të PBB-së	
10.6	Përputhshmëria e planeve strategjike me buxhet	>75%	>75%	
10.7	Menaxhimi i shërbimeve të TIK i rritur dhe i qëndrueshëm:	a) 24-72 orë	a) 1 min.	
	a) Kohëzgjatja e pranimin të pagesave	b) 25%	b) 100%	
	b) Konsolidimi dhe integrimi I infrastrukturës hardverike	c) 0	c) 60	
	c) Numri i sistemeve financiare kompatible sipas standardeve ndërkombëtare			

Strategjitë sektoriale

Në funksion të rritjes së performancës sipas qëllimeve strategjike, të cilat ndikojnë në arritjen e qëllimit zhvillimor, do të ketë nevojë që aspekte të caktuara të adresohen nëpërmjet strategjive sektoriale, si në vijim:

- Strategjia e reformës së administratës publike;
- Strategjia e qeverisjes elektronike;
- Programi për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative;
- Strategjia për menaxhimin e financave publike.

Strategji që do të mbesin në fuqi dhe do të adresojnë objektiva strategjike janë:

- Strategjia për bashkëpunim me shoqërinë civile (2019-2023);
- Programi për barazi gjinore (2020-2024);
- Strategjia për vetëqeverisje lokale (2016-2026).

Agjendat horizontale

Agjendat horizontale që adresohen nëpërmjet këtij qëllimi zhvillimor janë gjithëpërfshirja dhe agjenda digjitale.

Integrimi evropian

Në nivel vendi, rritja e efektivitetit të Qeverisë është e lidhur me integrimet evropiane, konkretisht me MSA (Kapitulli 32).

Përbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivat 5 dhe 16.



> QËLLIMI 11

Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar

Kosova është njohur nga 117 vende dhe është anëtarësuar në 145 organizata ndërkombëtare. Kosova ka hapur 33 ambasada në 33 vende të ndryshme, përfshirë zyrën ndërlidhëse në Serbi dhe 32 konsullata. Kosova përfaqësohet në të gjitha nismat rajonale me interes për të dhe është pjesë e rangimeve të ndryshme ndërkombëtare.

Kosova ka raporte të mira me vendet fqinje dhe ka vendosur marrëdhënie diplomatike me to, me përjashtim të Bosnje Hercegovinës dhe Serbisë. Kosova synon të fuqizojë raportet me Bosnje Hercegovinën përmes interesave të përbashkëta të qytetarëve të dy vendeve. Serbia nuk e ka njohur Kosovën, mirëpo kjo çështje dhe raporti në mes të dy vendeve pritet të vendoset në të ardhmen në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE dhe me praninë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve.

Kosova ka synim anëtarësimin në NATO, BE, Këshill të Evropës, Europol, Interpol dhe OKB. Aktualisht, Kosova është vend potencial kandidat për integritime në BE dhe ka marrëdhënie të mira me NATO. Në këtë aspekt, Kosova do të avancojë në dy drejtime, nëpërmjet zbatimit të MSA dhe marrjes së statusit të vendit kandidat për integritime në BE, si dhe anëtarësimin në mekanizmat e para anëtarësimin në NATO. Ndër të tjera, në njërin anë Kosova do të avancojë në forcimin e marrëdhënieve me shtetet që njohëse nëpërmjet krijimit të marrëdhënieve diplomatike me to, ndërsa në anën tjetër nëpërmjet krijimit të raporteve me vendet që ende nuk e kanë njohur atë nëpërmjet hapjes së zyrave ndërlidhëse në ato vende. Po ashtu, Kosova do të punojë në krijimin e kushteve për lëvizje të qytetarëve të saj pa viza, si brenda BE-së ashtu edhe në vendet tjera.

Sa i përket diasporës, Kosova do të trajtojë atë si potencial të jashtëzakonshëm në promovimin e imazhit të Kosovës dhe do të avancojë në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve të Kosovës jashtë vendit. Kjo do të bëhet nëpërmjet ruajtjes së identitetit, gjuhës dhe kulturës, me mbështetje të misioneve diplomatike dhe mësimit plotësues në gjuhën shqipe në shkollat me nxënës nga Kosova.

Në fushën e shërbimit diplomatik, Kosova do të reformojë atë duke ndërtuar një shërbim diplomatik profesional, kompetent, të karrierës dhe të pa ndikuar politikisht. Kjo do të bëhet nëpërmjet verifikimit të kompetencës së stafit diplomatik e konsullor dhe përzgjedhjes së stafit bazuar në meritë. Në këtë aspekt, do të intensifikohen trajnimet e diplomatëve nëpërmjet Akademisë Diplomatike dhe trajnimeve në vende tjera, sipas nevojës dhe kërkesës.

Treguesit e ndikimit

Treguesi i ndikimit 11.1

Numri i organizatave ndërkombëtare ku Kosova është anëtare

Treguesi matë forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës përmes anëtarësimit në org. ndërkombëtare.

baza:
145

2026
>160

2030
>180

Burimi: MPJD

Treguesi i ndikimit 11.2

Numri i vendeve ku Kosova mund të udhëtojë pa viza

Tregues nga databaza passport index, dhe paraqet vendet pa viza dhe ato ku merret viza ne kufi.

baza:
12 pa viza/39

2026
TBD

2030
TBD

Burimi: Indeksi i pasaportës

Qëllimet strategjike

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet nëpërmjet këtyre qëllimeve strategjike:

- 11.1. Fqinjësi e mirë dhe bashkëpunim rajonal;
- 11.2. Krijimi dhe forcimi i marrëdhënieve më vendet tjera;
- 11.3. Fuqizim i Diplomacisë së Diasporës;
- 11.4. Angazhimi dhe integrimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe strukturat euroatlantike
- 11.5. Fuqizimi i Diplomacisë Publike dhe Diplomacisë Ekonomike

Treguesit e rezultatit

Treguesit për matjen e performancës së qëllimeve strategjike:

QS	Treguesi i rezultatit	Baza	2026	2030
11.1	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara me vendet fqinje	TBD	TBD	TBD
11.2	Numri i ambasadave dhe konsullatave të Kosovës në vendet që e kanë njohur Kosovën	33 ambasada & 16 konsullata te përgjithshme dhe konsullata	TBD	TBD
	Numri i misioneve të veçanta (përfshirë zyrat ndërlidhëse) të Kosovës në vendet që nuk e kanë njohur Kosovën	2	TBD	TBD
	Numri i zyreve ndërlidhëse të Kosovës në vendet jo njohëse	2	>10	
11.3	Numri i projekteve investuese nga diaspora	TBD	TBD	TBD
	Numri i bizneseve të themeluara/regjistruara nga diaspora në Kosovë	74 (2021)	TBD	TBD
	Numri i aktiviteteve të diasporës jashtë vendit me qëllim promovimin e Kosovës	TBD	TBD	TBD

Strategjitë sektoriale

Në funksion të rritjes së performancës sipas qëllimeve strategjike, të cilat ndikojnë në arritjen e qëllimit strategjik, do të ketë nevojë që aspekte të caktuara të adresohen nëpërmjet strategjive sektoriale, si në vijim:

- Strategjia për politikën e jashtme.

Agjendat horizontale

Agjendat horizontale që adresohen nëpërmjet këtij qëllimi strategjik janë gjithëpërfshirja dhe agjenda digjitale. Ndërsa prioritetet për diasporën si një agjendë horizontale do të koordinohen në dokumentet strategjike sektoriale, si Strategjia për Arsim, për adresimin e objektivës së mësimin plotësues në gjuhën shqipe në vendet ku jeton diaspora e Kosovës.

Integrimi evropian

Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar është i lidhur edhe me agjendën e integritimeve evropiane, konkretisht politikën e jashtme (Kapitujt 30 dhe 31).

Përbushja e këtij qëllimi zhvillimor deri në vitin 2030 do të ndikoj drejtpërdrejtë edhe në arritjen e SDG, respektivisht objektivit 16.



6. Agjendat horizontale

Me anë të KPMS, SKZH 2030 definojnë si agjenda horizontale ato çështje apo fusha që kërkojnë koordinim ndërmjet shumë sektorëve, nëpërmjet objektivave dhe aktiviteteve të përbashkëta të disejuara për arritjen e objektivave në secilin prej sektorëve. Si të tilla, agjendat horizontale janë një dimension shtesë ndaj planifikimit të zakonshëm sektorial.

Karakteristikë e rëndësishme e agjendave horizontale është se veprimet konkrete do të zbatohen dhe financohen nga organizata të ndryshme buxhetore në disa sektorë. Prandaj, veprimet e tilla duhet të planifikohen dhe kostohen në strategjitë specifike sektoriale dhe të përfshihen në kërkesat buxhetore nga organizata përgjegjëse për zbatimin e veprimeve. Agjendat horizontale duhet të përdoren vetëm për qëllime të koordinimit dhe monitorimit.

Secila agjendë horizontale ka një institucion përgjegjës e cila mbikëqyrë zbatimin e saj. Bazuar në udhëzimin për agjendat horizontale që do të hartohet nga Zyra e Kryeministrit, udhëzohen ministritë tjera për përfshirjen e objektivave dhe veprimeve në dokumentet strategjike dhe planet e veprimit, së bashku me treguesit përkatës.

Duke u bazuar në këtë, SKZH 2030 identifikon objektiva dhe tregues që përkufizojnë agjendat horizontale si në vijim:

- **Agjenda digjitale** adreson mundësitë e digjitalizimit dhe shfrytëzimit të TIK, duke përfshirë sigurinë kibernetike, modernizimin e administratës publike, ofrimin e shërbimeve publike, kujdesin shëndetësor (tele-mjekësinë, shkëmbimin e të dhënave të pacientëve), arsimin (mjetet digjitale dhe mjediset e të mësuarit), zhvillimin e kulturës (digjitalizimin e trashëgimisë kulturore, arteve digjitale), digjitalizimin e sektorit privat.
- **Gjithëpërfshirja** (Të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta) adreson çështjet e të drejtave të njeriut, fuqizimin e rinisë, promovimin e të drejtave të fëmijëve, të drejtat e pakicave, promovimin e barazisë gjinore, përfshirjen e grupeve të cenueshme, ofrimin e mundësive të barabarta, si dhe komunitetin LGBTQ+.
- **Agjenda e gjelbër** adreson sfidat që kanë të bëjnë me dekarbonizimin, ndotjen, ekonominë qarkore, biodiversitetin dhe bujqësinë e zhvillimin rural.
- **Migrimi dhe diaspora** adreson çështjet ndërsektoriale, si fuqizimi i marrëdhënieve me diasporën, ruajtja e identitetit kulturor dhe angazhimi i diasporës në zhvillimin e vendit.

Agjendat horizontale, përveç që janë të shtrira në secilin sektor të politikave publike dhe në të gjitha shtyllat, qëllimet dhe objektivat e SKZH, ato përfshijnë edhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

6.1. Agjenda Digjitale e Kosovës

Digjitalizimi është një nga prioritetet kryesore të vendit. Për këtë arsye digjitalizimi është pjesë e katër shtyllave SKZH 2030, ku janë identifikuar objektiva dhe tregues nëpërmjet të cilëve planifikohen intervenime konkrete në sektorë të ndryshëm. Me qëllim të koordinimit të përpjekjeve në të gjithë sektorët e politikave publike, Qeveria, si pjesë të kornizës së saj strategjike, harton një dokument të veçantë të quajtur Agjenda Digjitale e Kosovës 2030. Agjenda digjitale është një dokument ndërsektorial që përcakton politikat dhe prioritetet në kontekst të transformimit të vazhdueshëm digjital të ekonomisë dhe shoqërisë, të ndikuara nga teknologjitë inovative dhe trendet globale digjitale. Nëpërmjet Agjendës Digjitale 2030,

Kosova do të shfrytëzojë zhvillimin e mundësive të teknologjive të avancuara të informimit dhe komunikimit për t'u bërë ekonomi dhe shoqëri digjitale dhe për të mbështetur rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë. Agjenda Digjitale e Kosovës 2030, koordinohet nga ministria përgjegjëse për politikën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Agjenda digjitale adreson shumë sektorë të politikave publike. Përderisa digjitalizimi i ekonomisë konsiderohet prioritet i lartë për vendin, në shtyllën e parë SKZH 2030 fokusin kryesor e paraqet në krijimin e një ekonomie inovative, qarkore dhe konkurruese, nëpërmjet krijimit të një klime të drejtë, të përshtatshme dhe konkurruese për bizneset, si dhe përshpejtimin digjital dhe inovacionit tek start-up bizneset dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo ka për qëllim transformimin digjital të bizneseve, duke mundësuar kështu zhvillimin e industrisë drejt produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar.

Ndonëse infrastruktura e përgjithshme e komunikimit në Kosovë është e vendosur, ka ende hapësirë për më shumë investime në këtë drejtim për përgatitjen e terrenit për një tranzicion të afërt në një ekonomi digjitale. Në këtë kontekst, në SKZH 2030 me prioritet të lartë është vendosur zhvillimi i rrjeteve dhe shërbimeve të sigurta të komunikimit elektronik me brez të gjerë me cilësi të lartë dhe përmirësimi i lidhjeve ndërkombëtare në telekomunikacion.

Përballja me pandeminë COVID-19, ka treguar shumë qartë rëndësinë e teknologjisë informative në shumë sfera të jetës. Prandaj, në kuadër të zhvillimit të barabartë njerëzorë janë përfshirë objektiva për digjitalizimin në fushën e arsimit, ofrimit të shërbimeve në shëndetësi, politika të punësimit dhe mirëqenie sociale. Duke pasur një popullatë të re, prioritet kryesor është avancimi i shkathtësive digjitale të qytetarëve, ngritja e cilësisë dhe transformimi i sistemit arsimor nëpërmjet digjitalizimit, promovimi i një ekosistemi inteligjent dhe sigurimi i një mjedisi të favorshëm për hulumtim dhe zhvillim në teknologjitë inovative. Reformat në sektorin e shëndetësisë për mundësimin e sigurimit shëndetësor universal duhet të shoqërohen në investimet e nevojshme në sistemin informativ shëndetësor. Zhvillimi i kulturës dhe trashëgimisë kulturore në veçanti, do të përfitojë nga mundësitë që ofrojnë teknologjitë digjitale. Promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore do të përfitojë nga ky momentum i rëndësishëm.

Në kuadër të sigurisë dhe sundimit të ligjit, fokus kryesor i SKZH-së në kuptimin e agjendës digjitale është zhvillimi dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike kombëtare. Intervenimet sektoriale sa i përket sigurisë kibernetike duhet të ndërlihen ngushtë me Strategjinë e Sigurisë, për të siguruar kështu koordinim të mirëfilltë të të gjitha institucioneve për zhvillimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës kundër krimeve kibernetike. Digjitalizimi i sistemit të drejtësisë është objektivi i rëndësishëm në kuadër të shtyllës së tretë. Investimet e fundit për sistemin për menaxhimin e rasteve, duhet të avancohen për të minimizuar përdorimin e letrave gjatë procedurave gjyqësore, për të mundësuar kështu qasje më të lehtë në drejtësi dhe rritje të efikasitetit të gjyqësorit.

Në kuadër të qeverisjes së mirë, objektivi me rëndësi është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për bizneset dhe qytetarët. Për këtë qëllim duke përdorur avancimin e qeverisjes elektronike planifikohet edhe zvogëlimi i barrës administrative, nëpërmjet një programi të veçantë. Kjo planifikohet të arrihet nëpërmjet avancimit të qeverisjes elektronike, digjitalizimit apo investimet infrastrukturore teknologjike për ndërlihen e regjistrave publik, gjenerimin automatik të të dhënave dhe krijimi i platformave elektronike, me anë të së cilave informohet dhe shërbehet qytetari, biznesi dhe vetë administrata.

6.2. Mundësi të barabarta

Gjithëpërfshirja paraqet qëllimin horizontal në kuadër të SKZH 2030, që synon të krijojë mundësi të barabarta për zhvillim, mirëqenie dhe jetë të shëndetshme në Kosovë. SKZH 2030 e cilëson gjithëpërfshirjen si të domosdoshme për arritjet në arsim, promovimin e barazisë gjinore, përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies, ofrimin e mundësive të barabarta, integrimin e personave me aftësi të kufizuara, fuqizimin e rinisë, angazhimi dhe mirëqenia për të moshuarit, grupet e cënueshme, si pakicat kombëtare dhe ato fetare, personat e

zhvendosur, komunitetin LGBTQ+, si dhe të drejtat gjuhësore për të gjitha komunitetet. Të gjitha këto kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Arritja e qëllimeve të përgjithshme të SKZH 2030 është e mundur vetëm nëse këto qëllime kanë qasje gjithëpërfshirëse, që me anë të zbatimit të SKZH 2030 sigurohen mundësi të barabarta për të gjithë pa dallim. Agjenda horizontale “Mundësi të barabarta”, koordinohet nga ana e zyrës përgjegjëse për të drejtat e njeriut dhe mundësive të barabarta.

Përfshirja e fëmijëve deri në moshën pesë vjeçare në edukim dhe arsim të hershëm, mundëson përmirësimin e rezultateve në arsim në nivelet më të larta, por edhe ndikon drejtpërdrejt në rritjen e mundësive për aktivizimin e grave në tregun e punës dhe luftimin e diskriminimit mbi baza gjinore. Për pakicat kombëtare, posaçërisht fëmijët e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian, është qenësore përmirësimi i qasjes në të gjitha nivelet e arsimit dhe promovimi i arsimit të strukturuar. Përmirësimi i infrastrukturës së arsimit për lehtësimin e qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim të organizuar, është kyç për arritjen e qëllimit të gjithëpërfshirjes dhe për adresimin e pabarazive në qasje në arsim, si dhe për uljen e numrit të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, që braktisin shkollimin e detyrueshëm.

Në tregun e punës, krijimi i mundësive të barabarta të punësimit për gratë dhe rininë, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të kornizës ligjore dhe planeve të veprimit që përmirësojnë mundësitë e punësimit, garanton zhvillim të tregut të punës dhe të sektorit privat. Investimet në kujdesin shëndetësor duhet të reflektojnë në rritje të jetëgjatësisë së përgjithshme, por veçanërisht duhet të adresojnë shëndetin e fëmijëve, me qëllim të uljes së shkallës së vdekshmërisë së fëmijëve, posaçërisht të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Shpenzimet për kujdesin shëndetësor janë të ulëta dhe mbulojnë vetëm 40% të nevojave vjetore të kujdesit shëndetësor publik. Në mungesë të sigurimit shëndetësor publik, vetëm 6.8% të popullsisë kanë sigurim privat. Kjo kosto e lartë e shëndetësisë është shpesh e papërbalueshme për familjet që jetojnë në prag të varfërisë. Në vitin 2017, rreth 50% e familjeve në Kosovë kanë deklaruar se nuk janë në gjendje të përballojnë shpenzime të papritura prej 500 euro e më shumë, që shpesh paraqet shpenzime të papritura dhe të larta shëndetësore. Prandaj, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të përgjithshme në shëndetësi dhe ndërtimi i sigurimit të qëndrueshëm shëndetësor, do të ndihmojnë në adresimin e këtyre sfidave.

Për shkak të targetimit të dobët të skemave dhe transfereve nga mbrojtja sociale, shpesh ata që kanë më së shumti nevojë nuk arrijnë të përfitojnë. Shpenzimet publike për mbrojtjen sociale, edhe pse në rritje, ende mbeten të ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Varfëria është edhe më e lartë në familjet e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian. Duke u bazuar në këtë, rishikimi i sistemit të mbrojtjes sociale është i domosdoshëm, në shërbim të zbutjes së varfërisë dhe pabarazisë.

Investimet në infrastrukturë sportive dhe në kulturë do të rrisin qasjen dhe mundësitë në këta sektorë për të gjithë, pa diskriminim. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik duhet të koncentrohet në krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë, në veçanti për tejkalimin e hendekut ekonomik të dallimeve rajonale, dallimeve qytet-fshat, si dhe dallimeve gjinore. Ndonëse me nivel të konsiderueshëm të investimeve, infrastruktura mbetet sfidë në rajone të caktuara, e veçanërisht në zonat rurale. Mungesa e qasjes në ujë të pijshëm, në sistem të kanalizimit dhe furnizim të qëndrueshëm me energji, rritë gjasat e ngecjes në zhvillim në disa rajone të caktuara.

6.3. Agjenda e gjelbër

Agjenda e Gjelbër synon adresimin e sfidave mjedisore dhe klimatike në rritje, duke e vënë zhvillimin e qëndrueshëm, efikasitetin e burimeve, mbrojtjen e natyrës dhe veprimin klimatik në thelb të të gjitha aktiviteteve ekonomike. Agjenda e Gjelbër synon adresimin e zotimeve të Qeverisë së Kosovës për Agjendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor. Agjenda e gjelbër koordinohet nga ana e ministrisë përgjegjëse për mjedisin

Një qasje e integruar për tranzicionin e gjelbër, kërkon koordinim të fuqishëm institucional dhe vendimmarrje ndërsektoriale, mbështetje në zbatimin e politikave dhe ngritje të kapaciteteve. Për më tepër, për të siguruar zbatimin e agjendës, kërkohet përfshirje e tërë shoqërisë, plane të dedikuara dhe të integruara financiare që mundësojnë zbatimin e saj. Agjenda e Gjelbër trajtohet si një element i rëndësishëm rreth parimeve të një ekonomie me mjedisin në qendër, e përcaktuar nga rritja e qëndrueshme, konsumi i qëndrueshëm i burimeve dhe zvogëlimi i emetimeve të karbonit. Përderisa zhvillimi ekonomik tradicional është i drejtuar nga fitimi, rritja e gjelbër e vendos mirëqenien njerëzore në qendër të zhvillimit ekonomik dhe përpiqet të minimizojë dëmin mjedisor.

Si pjesë e kornizës strategjike horizontale, Agjenda e Gjelbër është pjesë e SKZH 2030 e cila përcakton politikat dhe prioritetet në kontekstin e transformimit të Kosovës në një shoqëri të drejtë dhe prosperuese, me një ekonomi moderne, efikase në burime dhe konkurruese. Nëpërmjet Agjendës së Gjelbër, Kosova synon të jetë një nga vendet e para në rajon në transformimin e ekonomisë dhe shoqërisë e saj në një rrugë të qëndrueshme.

Te zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, fokus kryesor i SKZH 2030 është zhvillimi i industrisë drejt një ekonomie qarkore, me fokus në teknologjinë e pastër, që synon produkte dhe shërbime me vlerë të shtuar. Në këtë aspekt do të synohet zhvillimi i biznesit të vogël dhe të mesëm në ngritjen e kapaciteteve për investime nga ekonomia lineare në atë të gjelbër dhe me hapa në rritje drejt zbatimit të plotë të ekonomisë qarkore që do të jetë çelësi për zhvillimin e modelit të ardhshëm ekonomik të Kosovës. Kjo dërgon në transformimin në ekonomi qarkore, që rezulton me eliminimin e mbeturinave, qarkullimin e burimeve dhe rigjenerimin e natyrës, duke ndërtuar kështu konkurrencën për Kosovën në një epokë të re të ekonomisë ndërkombëtare dhe tregut të BE-së. Një qasje e integruar ndaj menaxhimit të mbeturinave, infrastrukturës përkatëse dhe ekonomisë rrethore, do të jetë shtytësi për një model të ri ekonomik në Kosovë.

Një zhvillim ekonomik i tillë nuk do të mund të bëhej pa një infrastrukturë të cilësisë së lartë, të qëndrueshme dhe të integruar, ku fokus kryesor do të jetë përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji të qëndrueshme dhe të përballueshme dhe përmirësimi infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit, duke i integruar me tregjet rajonale dhe evropiane. Në këtë aspekt efikasiteti i burimeve mbështetet në zhvillimin ekonomik të emetimeve të ulëta, duke nxitur efikasitetin e energjisë, burimeve të ripërtëritshme dhe përmirësimin e transportit për të ulur emetimet e karbonit dhe varësinë nga lëndët djegëse fosile. Ky synim ndikon edhe në sektorin e arsimit, i cili luan rol të rëndësishëm që fuqia punëtore të Kosovës, të fitoj aftësitë që i nevojiten për transferimin nga sektorët në rënie në sektorët në rritje. Nëpërmjet ngritjes së gatishmërisë së reagimit ndaj emergjencave, do të ndërtohet qëndrueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike.

Agjenda e Gjelbër parashikon fushat kryesore të investimeve, me fokus në sektorin e energjisë, transportit, zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, arsimin dhe zhvillimin e fuqisë punëtore. Rezultatet janë të lidhura me shtatëmbëdhjetë SDG-të e përshkuara në Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike, zhvillimin dhe rritjen e qëndrueshme, menaxhimin efikas të burimeve natyrore, sigurinë ushqimore, kohezionin social dhe emetimin më të ulët të karbonit dhe infrastrukturën e modernizuar.

6.4. Migrimi dhe Diaspora

Migrimi është një nga çështjet kryesore që përcjell zhvillimin e një vendi. Kosova synon të zbatojë objektivat e Kompaktit Global për migrim të sigurtë, organizuar dhe të rregullt. Kosova ia ka dalë që me sukses të përmirësojë situatën rreth menaxhimit të migrimit, sidomos atij të parregullt, ndonëse numri i qytetarëve të Kosovës të cilët emigrojnë për punë, edukim dhe bashkim familjar mbetet i lartë. Gjithashtu, Kosova ka ngritur kapacitetet për të menaxhuar migrimin dhe do të vazhdojë përpjekjet për fuqizimin e menaxhimit të integruar të kufirit dhe kapacitetet për pranim të emigrantëve, duke fuqizuar mbrojtjen dhe qasjen e bazuar në të drejta të njeriut dhe fuqizimin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Agjenda horizontale “Migrimi dhe Diaspora” koordinohet nga ana e ministrisë përgjegjëse për diasporën, me mbështetje të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme.

Migrimi kërkon menaxhim të mirë dhe një qasje gjithëpërfshirëse të bazuar në të dhëna për të maksimizuar potencialin e tij dhe për të arritur rezultate të zhvillimit të qëndrueshëm për migrantët dhe shoqërinë. SKZH 2030 parasheh krijimin e sistemeve për menaxhimin më të mirë të migracionit për motive punësimi, të propozohen shtigje të rregullta të migrimit dhe të ndërtohen kapacitete për adresimin e migracionit për motive punësimi, veçanërisht emigracionin jashtë dhe lëvizshmërinë e shkathtësive (ikjen e trurit). Po ashtu, nëpërmjet dokumenteve tjera strategjike, do të parashihen politika për shmangjen e shfrytëzimit dhe abuzimit të punëtorëve migrantë, promovimin e migrimit qarkor, adresimin e mungesës të shkathtësive, përmirësimin e rregullimit të rekrutimit ndërkombëtar dhe mbrojtjen e kushteve që sigurojnë punë të denjë. Sa i përket kthimit të migrantëve, synohet të zbatohen masa gjithëpërfshirëse për mbështetjen e riintegrit të qëndrueshëm të të kthyerve, duke përfshirë personat e zhvendosur.

Në anën tjetër, Kosova ka një nga diasporat më të mëdha të rajonit. Në vitin 2020 remitencat përbënin 18.6% të BPV. Diaspora i ka ndihmuar zhvillimit të vendit në mënyra të ndryshme, nëpërmjet investimeve, mundësimin të shkëmbimeve të ndryshme, arsimit, etj. Megjithatë, Kosova ende përballet me një numër sfidash sa i takojnë migrimit dhe diasporës. Viteve të fundit, një numër i madh i kosovarëve kanë shfrytëzuar mundësitë e migrimit të rregullt për të emigruar në vendet e BE-së. Kosova nuk ka qenë mjaft e suksesshme që ndihmën financiare të diasporës ta orientojë drejt investimeve, hapjes së bizneseve, arsimit e shëndetësisë.

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, kontributi i diasporës pritet të rritet sidomos pas ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve, uljes së varësisë në importe dhe rritjes së investimeve të orientuara në eksporte. Arritja e këtyre synimeve do të ndikojë në mënyrë pozitive në uljen e kërkesës për migrim jashtë vendit dhe në një fazë më të vonshme, edhe në kërkesën për kthim.

Në kuadër të zhvillimit njerëzor, diaspora dhe migrimi luajnë rol të rëndësishëm. Kontributet më të rëndësishme të diasporës në këtë fushë ndërlidhen me objektivin e arsimit dhe punësimin cilësor, posaçërisht me harmonizimin e arsimit me nevojat e tregut të punës, konkurrueshmërinë në arsimin e lartë me përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve të punësimin.

Në kuadër të sigurisë dhe sundimit të ligjit, aspektet kryesore të migrimit dhe diasporës ndërlidhen me sigurinë në bashkësi, pasi që ndikimet e migrimit në këtë aspekt ndërlidhen me migrimin e parregulltë si dhe rrezikun e kontrabandimit të migrantëve. Masat kryesore zbatuese janë përpjekjet për mbajtjen e ultë të numrave të migrimit të parregullt, përmes riatdhesimit dhe ri integrit, rritjes së kapacitetit për luftimin e kontrabandimit të migrantëve dhe përballjes me flukset e imigrantëve të parregulltë. Gjithashtu, Kosova synon të zbatojë objektivat e Kompaktit Global për refugjatë, nëpërmjet promovimit në mënyrë aktive të përfshirjes dhe integritin të refugjatëve në proporcion me kapacitetin e vendit, që mundëson qasje inovative dhe individuale të integrit, marr parasysh situatat, nevojat dhe shkathtësitë individuale.

7. Financimi i SKZH 2030

Parashikimet financiare për PKZH 2030 mundësojnë përshtatjen e nevojave të sektorëve me të ardhurat e disponueshme në një perspektivë afatgjatë. Projektionet për zbatimin e PKZH 2030 janë bazuar në një qasje shumë dimensionale, duke përdorur projeksionet e KASH 2022-2025, kufijtë e shpenzimeve për organizata buxhetore dhe supozime për projeksione afatgjata.

Hapësira fiskale shtesë e identifikuar është vënë dispozicion për zbatimin e qëllimeve dhe qëllimeve të PKZH 2030. Hapësira fiskale e identifikuar në këtë dokument, bazohet në një skenar që supozon se Qeveria nuk do t'i ndajë ato fonde për qëllime të tjera, përveç zbatimit të PKZH 2030 dhe se nuk do të shtohet asnjë zë shpenzimi ose të prezantohen ndryshime fiskale që ndikojnë në të hyrat për periudhën e mbuluar në PKZH 2030. Parashikimet afatgjata për 2026-2030 janë të përgatitura mbi pasiguri që lidhen me zhvillimet ekonomike, zhvillimet politike dhe masat e tjera të mundshme fiskale në të ardhmen.

BPV-ja nominale, të hyrat e përgjithshme, shpenzimet buxhetore dhe zërat e tjerë për 2022-2025 bazohen në parashikimet më të fundit në KASH, për periudhën 2022-2025, ku është identifikuar vetëm hapësira shtesë fiskale që mund të vihej në dispozicion. Për vitet 2026-2030:

- Projektionet për BPV-së nominale bazohen në projeksionet e ASK për popullsinë në moshë pune, duke përdorur raportin midis rritjes ekonomike dhe rritjes së popullsisë në moshë pune.
- Projektionet e të hyrave vlerësohen duke përdorur një peshë mesatare historike ndaj BPV-së, pa parashikuar rritje që vjen nga ulja e hendekut tatimor, e cila do të paraqiste të hyra shtesë mbi ato të shtyra nga zhvillimi ekonomik.
- Projektionet e shpenzimeve vlerësohen duke përdorur një përqindje mesatare historike ndaj BPV-së, bazuar vetëm në rritjen ekonomike, pa marrë parasysh ndonjë zë shpenzimi të njëhershëm që mund të prezantohet. Fatura e pagave parashikohet të rritet bazuar në normën maksimale të rritjes, bazuar në rritjen nominale të BPV-së të vitit të kaluar. Shpenzimet për interes parashikohen të rriten duke përdorur një peshë konstante ndaj totalit të shpenzimeve, si në vitet 2020-2025, pasi financimi është rritur ndjeshëm në vitet e pandemisë dhe një peshë më e gjatë historike do të çonte në një nënvlerësim. Projektionet e klauzolës investuese bazohen në projeksionet e KASH, ndërsa për periudhën më të gjatë nuk bëhen supozime pasi që për qëllim të hapësirës fiskale nuk mund të rialokohen ato mjete.
- Shpenzimet kapitale janë projektuar duke përdorur një peshë mesatare historike ndaj BPV-së, ndërsa 20% e shpenzimeve kapitale nga buxheti i rregullt supozohen si hapësirë shtesë për shkak të një norme historike të nën ekzekutimit. Gjithsesi, duhet theksuar se rialokimet buxhetore kanë kufizime ligjore dhe mund të bëhen vetëm në dy muajt e fundit të vitit, kështu që një hapësirë e tillë duhet marrë me kujdes. Për llogaritjen e hapësirës fiskale për SKZH 2030 merret parasysh edhe kufizimi i rregullit të deficitit prej 2% ndaj BPV-së, pra për çdo vit supozohet se arrihet rregulli maksimal i deficitit.

Tabela 3. Skenari Bazë - Treguesit kryesorë të të hyrave dhe shpenzimeve

Skenari Bazë	Projeksionet e KASH				Projeksionet Afatgjata				
	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
<i>Në milionë Euro</i>									
Të hyrat buxhetore totale	2,430	2,677	2,864	3,048	3,251	3,436	3,626	3,819	4,028
Të hyrat	2,408	2,654	2,842	3,025	3,228	3,413	3,604	3,797	4,005
Grantet dhe Grantet e Dedikuara të Donatorëve	23	23	23	23	23	23	23	23	23
Shpenzimet Buxhetore	2,898	2,975	3,113	3,203	3,450	3,637	3,829	4,022	4,231
Paga dhe Shtesa	671	695	719	724	776	817	864	912	961
Interesi	41	47	52	58	56	60	63	66	70
Shpenzimet Kapitale (të rregullta)	570	650	760	773	763	805	847	890	936
Deficiti i Përgjithshëm	(467)	(297)	(248)	(154)	(199)	(201)	(202)	(203)	(203)
Klauzola e Investimeve	113	143	156	214					
Deficiti sipas rregullës fiskale	(332)	(154)	(92)	59	(199)	(201)	(202)	(203)	(203)
Deficiti sipas rregullës fiskale (% e BPV)	-3.8%	-1.6%	-0.9%	0.5%	-1.7%	-1.6%	-1.5%	-1.5%	-1.4%
BPV Nominale	8,755	9,621	10,408	11,156	11,740	12,413	13,105	13,807	14,565
Rritja e BPV Nominale		9.9%	8.2%	7.2%	5.2%	5.7%	5.6%	5.4%	5.5%
Hapësira Fiskale (nga deficiti)		38.	117	282	36	47	60	73	88
Nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale (rreth. 20%)		130	152	155	153	161	169	178	187
Hapësira Fiskale (deficit + nën ekzekutim i shpenzimeve kapitale)		168	269	437	189	208	229	251	275
Hapësira Fiskale (% e BPV)		1.7%	2.6%	3.9%	1.6%	1.7%	1.7%	1.8%	1.9%

Sa i përket shpenzimeve për sektor, një peshë konstante e shpenzimeve është supozuar si në periudhën 2022-2024 bazuar në Ligjin e buxhetit 2022. Ndarjet sektoriale janë bërë duke përdorur klasifikimin e ri i cili përfshinë 16 sektorë të shpenzimeve. Si rezultat, ka pasur një rigrupim të sektorëve bazuar në klasifikimin COFOG të paraqitur në organizatat buxhetore në klasifikimet e reja sektoriale të bazuara në SKZH 2030.

Shtojca B paraqet shpenzimet e alokuara për secilin sektor dhe plotësohet me hapësirë shtesë që rrjedh nga hapësira fiskale në dispozicion të SKZH 2030. Ndarja e hapësirës fiskale shtesë të SKZH-së në çdo sektorë është bërë duke marrë parasysh qëllimet e SKZH 2030 për sektor, si dhe prioritetet e identifikuar nga ministritë e linjës.


Bazuar në prioritetet e SKZH 2030, dy sektorët që kanë peshë më të madhe në krahasim me alokimet historike të sektorëve janë 1. Energjia dhe 2. Mbrojtja. Pjesa tjetër e hapësirës shtesë të ndarë sipas sektorëve vjen nga prioritetet e ministrisë së linjës, kreditë dhe grantet e identifikuar. Duhet theksuar se gjatë procesit të konsultimit me ministritë e linjës janë identifikuar të dhëna në lidhje me grantet të cilat siç janë paraqitur në shtojcën 2 paraqiten si hapësirë shtesë e disponueshme për zbatimin e prioritetëve të SKZH 2030.

8. Zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi

Zbatimi i PKZH 2030 do të realizohet nëpërmjet strategjive sektoriale dhe planeve të tyre të veprimit, të cilat do të përfshihen në planin operacional të PKZH-së. Planet e performancës së agjencive kontribuojnë në portofolin e ministrisë të planit operacional. Të dhënat e monitorimit do të mblidhen çdo tremujor për zbatimin e planit operacional dhe çdo vit për nivelin e arritjes së objektivave strategjike dhe zhvillimore. Raportet e rregullta të progresit do të përgatiten nga poshtë lart, duke mbledhur dhe konsoliduar të dhëna në çdo nivel.

ZKM është përgjegjëse për koordinimin e procesit të mbledhjes së të dhënave nga poshtë-lart nga ministrinë dhe agjencitë e pavarura dhe përpilimin e një raporti gjithëpërfshirës vjetor për progresin e PKZH 2030.

Figura 6. Korniza e Planifikimit dhe Menaxhimit Strategjik: kaskada e objektivave dhe treguesve



Matja e performancës përgjatë dokumenteve të planifikimit strategjik mbështetet në katër nivele qëllimesh, nga afatgjata në afatshkurtër, strategjik në operacional, secili i shoqëruar nga tregues të performancës të drejtuar drejt një objekti të caktuar:

- **Qëllimet zhvillimore** – të shoqëruar me tregues të ndikimit të SKZH-së, që tregojnë nëse një mundësi është arritur në nivel të shoqërisë;
- **Qëllimet strategjike** – e shoqëruar me tregues të ndikimit; tregon përfitimet e një grupi të caktuar për të cilin janë planifikuar masat;
- **Masa strategjike** – të shoqëruar me tregues të rezultatit; dhe
- **Aktivitetet (strategjike)** të shoqëruar me tregues të produktit.

Siç është paraqitur në figurën e mësipërme, këto elemente shtrihen në formë kaskade nga SKZH 2030 deri në strategjitë sektoriale dhe planet për zbatimin e tyre dhe eventualisht në Planet Operacionale të Qeverisë.

Frekuenca e matjes së progresit kundrejt objektivave ndryshon edhe në nivel aktiviteti, do të bëhet çdo tre muaj në nivel të objektivave specifike dhe strategjike në nivel vjetor dhe në nivel të objektivave të zhvillimit të SKZH 2030 në një perspektivë katër vjeçare.

Gjithashtu edhe instrumentet e matjes dallojnë:

- **Në nivel të produktit** do të vlerësohet dhe të raportohet nëse aktivitetet kanë arritur në rezultat të cilësisë së pritur, kornizës kohore dhe kostos së arsyeshme (duke numëruar aktivitetet e kryera me sukses);
- **Në nivelin e rezultatit** është e nevojshme të vlerësohet nëse rezultati i arritur ishte ai i synuar në fazën e planifikimit dhe nuk prodhon efekte anësore të padëshiruara (mbledhja e informacionit statistikor ose administrativ dhe interpretimi i rezultateve);
- **Në nivelet e ndikimit** (si në nivel të qëllimeve strategjike shtu edhe në nivel të qëllimeve zhvillimore) është e nevojshme të analizohet nëse ndikimi është arritur për shkak të rezultateve (rezultati i vetë masave të politikave të zbatuara) ose nëse ka pasur faktorë të tjerë që kanë kontribuar në arritjen e tij ose çfarë e ka penguar realizimin e tij (duke përdorur një metodologji vlerësimi të bazuar në të dhënat e performancës të kombinuara me statistika kombëtare dhe raporte nga institucionet ndërkombëtare, të cilat çojnë në një analizë më të gjërë të faktorëve të rëndësishëm për politikën).


Procesi i raportimit vjetor të PKZH 2030 varet nga shpejtësia dhe cilësia e mbledhjes së të dhënave. Deri në fund të tremujorit të parë të vitit vijues, ZKM mbledh informacione nga ministrinë dhe institucionet tjera publike për vitin paraprak. Gjithashtu, raportimi për zbatimin e agjendave horizontale koordinohet nga ZKM në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për ato agjenda horizontale, bazuar në udhëzimet për zbatimin e agjendave horizontale (të cilat do të zhvillohen në fillim të vitit 2023). Raportet vjetore të zbatimit të buxhetit mund të jenë gjithashtu të rëndësishme për rishikimin e performancës së PKZH-së.

Raporti vjetor i zbatimit të PKZH 2030 hartohet nga ZPS. Drafti i raportit do të përpilohet nga ministrinë si pjesë e raportimit vjetor të punës së tyre dhe do të diskutohet në tre nivele:

- **Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik**, i kryesuar nga Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik në kuadër të ZKM-së, me përbërje nga drejtorët e zyreve kryesore të ZKM-së, ministrinë përgjegjëse për financa dhe ministrinë përgjegjëse për administratën publike, i cili vlerëson realizimin e draft raportit dhe çështje me interes potencial për Qeverinë;
- **Bordi i Sekretarëve të Përgjithshëm të ministrive**, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së, i cili adreson çështje që ngritën nga Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik, diskuton çështje të përmirësimit të efektivitetit të politikave, identifikon çështje të cilat kërkojnë vëmendjen politike dhe i sugjeron Qeverisë miratimin e draft raportit;
- **Komisioni për Planifikim Strategjik**, i kryesuar nga Kryeministri, adreson çështjet e ngritura nëpërmjet Bordit të Sekretarëve të Përgjithshëm të ministrive, shqyrton dhe e miraton raportin.

Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të ZKM-së në një seksion të caktuar për PKZH 2030.

Figura 7. Kuadri institucional për monitorim dhe raportim



Vlerësimi i zbatimit të Planit Kombëtar për Zhvillim 2030

ZKM është përgjegjëse për organizimin e vlerësimit të progresit dhe të performancës të PKZH-së 2030. Do të organizohen tri faza të vlerësimit:

- Vlerësimi i ndërmjetëm në vitin 2026;
- Vlerësimi i dytë në vitin 2029 për të informuar procesin e përgatitjes së PKZH-së së ardhshme; dhe
- Vlerësimi *ex-post*.

Në varësi të situatës me progresin e PKZH 2030 dhe vëzhgimit të ndryshimeve në kontekstin social dhe ekonomik, mund të ketë nevojë për ndryshimin e kohës së vlerësimit të parë dhe të dytë. Vlerësimit mund t'i nënshtrohet tërë PKZH 2030 apo vetëm një pjesë e saj.

Nevoja për të dhëna dhe përmirësimi

Për të mundur monitorim dhe vlerësim të suksesshëm të PKZH-së, është e nevojshme të përmirësohet mbledhja e të dhënave në lidhje me të gjithë sektorët dhe nivelet e informacionit të performancës. Publikimi i të dhënave në periudhat e mëparshme është gjithashtu vendimtar për monitorimin e PKZH-së. Rëndësi të veçantë për sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të progresit në zbatimin e strategjisë është zbatimimi i të dhënave sipas vendbanimit, gjinisë, përkatësisë etnike, moshës dhe parametrevave të tjerë aty ku janë relevante dhe të realizueshme.

Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për mbledhjen, analizën dhe publikimin e të dhënave në nivel vendi duhet të përfshihen në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave dhe tejkalimin e hendekut të monitorimit. Duke pasur parasysh mungesën e disa të dhënave, treguesit specifikë mund të kërkojnë një përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e proceseve aktuale të mbledhjes së të dhënave, analizës së politikave dhe praktikave të vlerësimit, si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave në nivel vendi, që të gjitha i shërbejnë një zhvillimi më profesional të politikave bazuar në prova dhe të dhëna. Mungesa e të dhënave janë identifikuar gjithashtu gjatë zhvillimit të strategjisë (një listë e treguesve për të cilët mungojnë të dhënat është paraqitur në Aneksin A.1.).



9. Shtojcat

A. Lista e treguesve për të cilët mungojnë të dhëna

Nr.	Treguesi	Përshkrimi	Veprimet që duhet të ndërmerren
Shtylla e parë – Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik			
1.	Infrastruktura (0-100)	<p>Indeksi Global i Konkurrueshmërisë (Shtylla II), mat lidhjen rrugore, cilësinë e infrastrukturës rrugore, dendësinë e hekurudhave, efikasitetin e shërbimeve të trenave, lidhjen e aeroportit, efikasitetin e shërbimeve të transportit ajror, lidhjen e transportit të linjës, efikasitetin e shërbimeve të portit detar, qasjen e energjisë elektrike, cilësinë e furnizimit me energji elektrike, ekspozimin ndaj ujit të pijshëm të pasigurt dhe besueshmëria e furnizimit me ujë. Rezultatet (pikët) sillen nga 0-100, ku sa më i lartë të jetë rezultati aq më mirë.</p> <p>Për detajet metodologjike, duhet të konsultohet vegëza në vijim: https://www3.weforum.org/docs/WEF_TheGlobalCompetitivenessReport2020.pdf. Në faqen 617-619, tregohet metodologjia e secilit nën-tregues që përdoret për përpilimin e treguesit të infrastrukturës, ndërsa në faqet 633-639 ofrohen detaje mbi mënyrën e anketës me biznese.</p>	Në mënyrë që ky tregues të prodhohet me saktësi dhe të jetë i krahasueshëm ndërkombëtarisht, është mirë që Kosova të synojë përfshirjen në Indeksin Global të Konkurrueshmërisë.
2.	Produktiviteti i resurseve	Treguesi është një masë e sasisë së përgjithshme të materialeve të përdorura drejtpërdrejt nga një ekonomi (e matur si konsumi i brendshëm i materialit (KBM)) në lidhje me BPV-në. Ky tregues pasqyroni nëse po ndodh shkëputja mes përdorimit të resurseve natyrore dhe rritjes ekonomike.	Agjencia e Statistikave të Kosovës
3.	Përdorimi i materialit të ricikluar	Treguesi mat pjesëmarrjen e materialit të ricikluar dhe të kthyer përsëri në ekonomi - duke kursyer kështu nxjerrjen e lëndëve të para primare - në përdorimin e përgjithshëm të materialit. Përdorimi qarkor i materialit, i njohur gjithashtu si shkalla e qarkullimit, përcaktohet si raporti i përdorimit rrethor të materialeve me përdorimin e përgjithshëm të materialit.	Në SKZH është vendosur një vlerësim i përafërt në bazë të një studimi të mëhershëm, megjithatë për këtë duhet të zhvillohet metodologjia dhe procesi për grumbullimin e të dhënave dhe raportimin për këtë tregues.
4.	Mbetjet e ngurta komunale të ricikluara në totalin e mbetjeve komunale të krijuara (%)	Treguesi mat tonazhin e ricikluar nga mbetjet komunale pjesëtuar me totalin e mbetjeve komunale që dalin. Riciklimi përfshin riciklimin e materialeve, kompostimin dhe tretjen anaerobe.	Në SKZH është vendosur një vlerësim i përafërt në bazë të një studimi të mëhershëm, megjithatë për këtë duhet të zhvillohet metodologjia dhe procesi për grumbullimin e të dhënave dhe raportimin për këtë tregues.

Nr.	Treguesi	Përshkrimi	Veprimet që duhet të ndërmerren
<p> Shtylla e Dytë: Zhvillimi i barabartë njerëzor</p>			
5-	Përqindja e mësimdhënësve, nxënësve, dhe personelit arsimor me kompetenca digjitale	<p>Përqindja e mësimdhënësve, personelit udhëheqës e administrativ të institucioneve arsimore dhe nxënësve që dëshmojnë kompetencë digjitale themelore në fusha përkatëse që lidhen me rolin e tyre.</p> <p>“Kompetenca digjitale” është një nga tetë kompetencat e përfshira në Kuadrin Evropian të kompetencave kyçe për mësimin gjatë gjithë jetës dhe si të tillë MASHTI e konsideron kyç në digjitalizimin e sektorit të arsimit.</p>	Ky tregues është pjesë e Strategjisë së Arsimit të Kosovës.. MASHTI ka paraparë zhvillimin e një analize për të përcaktuar gjendjen aktuale në kompetenca digjitale, të cilat do të informojnë mekanizmat për matjen e përparimit në këtë tregues.
6.	Përqindja e shkollave me qasje në internet dhe kompjuter	Përqindja e shkollave me qasje në internet dhe kompjuter.	<p>Ky tregues ndërlidhet drejtpërdrejt me OZHQ 4.a.1 (b&c) dhe me Strategjinë e Arsimit të Kosovës (SAK).</p> <p>Në kuadër të raportimit për OZHQ dhe për SAK, do të mblidhen të dhënat për këtë tregues. Edhe pse nuk ka të dhëna bazë, në kuadër të SAK janë zhvilluar edhe synimet për këtë tregues.</p>
7-	Përqindja e sistemimit të të diplomuarve nga IAAP, në profesionet përkatëse dhe në arsimin e lartë	<p>Punësimi i të rinjve të diplomuar nga IAAP. Të dhënat do të mblidhen nga studimet gjurmuese të realizuara nga MASHTI me të diplomuarit nga IAAP. Treguesi është paraparë në Strategjinë e Arsimit të Kosovës.</p> <p>Studimet gjurmuese janë mënyra më e saktë për të analizuar suksesin e IAAP dhe të ndërlidhjes së këtij niveli të arsimit me tregun e punës.</p>	<p>Duke qenë që MASHTI ka paraparë realizimin e këtyre studimeve, që do të informojnë vlerën bazë, kur ato të realizohen, por mbi të gjitha do të informojnë nivelin e realizimit të synimeve në këtë tregues.</p> <p>Ky tregues është pjesë e Strategjisë së Arsimit të Kosovës. Edhe pse nuk ka të dhëna bazë, në kuadër të SAK janë zhvilluar edhe synimet për këtë tregues.</p>
8.	Shkalla e punësimi pas përfundimit të arsimit të lartë (studime gjurmuese)	Shkalla e punësimi ose ndjekjes së arsimit të lartë pas përfundimit të arsimit të lartë (studime gjurmuese).	<p>Treguesi është paraparë në Strategjinë e Arsimit të Kosovës.</p> <p>MASHTI ka planifikuar realizimin e studimeve gjurmuese me ata që përfundojnë arsimin e lartë. Edhe pse nuk ka të dhëna bazë, këto studime do të realizohen brenda kohës së implementimit të SKZH dhe do të informojnë progresin drejt synimeve në këtë tregues.</p>

Nr.	Treguesi	Përshkrimi	Veprimet që duhet të ndërmerren
9.	Përqindja e personave të moshës 30-34 me arsim të lartë	Përqindja e personave të moshës 30-34 vjeç me arsim të lartë	<p>Ky tregues është përfshirë si një ndër treguesit kryesor të nivelit të arsimit të lartë në popullsi, të zhvilluar sipas Eurostat.</p> <p>Vlera e këtij treguesi varet nga të dhënat e censusit, dhe si rezultat, vlera bazë do të mund të llogaritet pas përfundimit të censusit të radhës.</p>
10.	Numri i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore	Numri i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore në të cilat Institucionet publike të Arsimit të Lartën në Kosovë janë partnerë.	Tregues i cili shërben për të vlerësuar cilësinë në arsimin e lartë dhe nivelin e ndërkombëtarizimit të programeve në arsimin e lartë. Është përfshirë në linjë me SAK.
11.	Përqindja e të rinjve në skema të punës praktike Tregues alternativ: Buxheti i alokuar për skema të punës praktike,	Përqindja e të rinjve që marrin pjesë në skema të punës praktike.	APRK duhet të bashkëpunojë me institucionet tjera duke përfshirë partnerët zhvillimorë, për të siguruar grumbullimin e të dhënave për të gjitha skemat e punës praktike të ofruar për të rinjtë.
12.	Përqindja e profileve të arsimit profesional që mundësojnë mësimin praktik.	Përqindja e kualifikimeve që ofrohen nga IAAP-të për të cilat mundësohet realizimi i mësimin praktik.	Edhe ky tregues është në linjë me SAK. Duke qenë që sistemi i arsimit dhe aftësimin profesional është në proces të reformimit, këto të dhëna do të jenë të qasshme gjatë zbatimit të SKZH.
13.	Menaxhimi i Qëndrueshëm i trashëgimisë kulturore	Paraqet listën kontrolluese lidhur me kornizën e menaxhimit të qëndrueshëm për të mbrojtur dhe menaxhuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore, praktikat, njohuritë dhe artefaktet historike të luajtshme.	
14.	Kultura në Bruto Produktin Vendor	Përqindja e Bruto Prodhimit Vendor që i atribuohet prodhimit kulturor formal dhe në sektorin privat. Ky tregues synon të vlerësojë kontributin e përgjithshëm të sektorit të kulturës në ekonomi në një territor të caktuar. Ai përputhet me klasifikimin ndërkombëtar të Kornizës për Statistikat në Kulturë.	
15.	Hapësirat sportive	Hapësirat sportive për përdorim, m2 për popullsi.	Ky tregues që do të matet në kuadër të përgatitjes së Strategjisë së Sportit, dhe do të raportohet në këtë strategji.

Nr.	Treguesi	Përshkrimi	Veprimet që duhet të ndërmerren
 Shtylla e tretë – Siguria dhe sundimi i ligjit			
16.	Indeksi i Sigurisë Kibernetike Globale	Vlerëson përgatitjen e vendit përmes masave ligjore, teknike, organizative dhe ato të ngritjes së kapaciteteve	Kosova tani për tani nuk është e përfshirë në këtë indeks
17.	Prevalenca e përdorimit të narkotikëve tek të rinjtë	Përqindja e popullatës që përdorë narkotikë	Gjendja bazë për këtë tregues është marrë viti 2014, i cili është publikuar nga një <u>raport i Qendrës Evropiane për monitorimin narkotikëve dhe varësisë nga narkotikët (EMCDDA)</u> por duke qenë se konsiderohet tregues i rëndësishëm është vendosur në SKZH. MPB duhet të ndërmerr masa për vendosjen e metodologjisë dhe grumbullimin e të dhënave për këtë tregues.
18.	Projekti i Drejtësisë Botërore – dhe tregues të tjerë që dalin nga raporti i rregullt Projekti i Drejtësisë Botërore	Vlerëson mekanizmat e ZAK <ul style="list-style-type: none"> • Matë perceptimin e ekspertëve në këtë fushë • Matë perceptimin e ekspertëve në këtë fushë • Matë perceptimin e ekspertëve në këtë fushë • Matë perceptimin e ekspertëve në këtë fushë • Matë perceptimin e ekspertëve në këtë fushë • Matë besimin e qytetarëve për drejtësi • Matë perceptimin e ekspertëve në këtë fushë • Matë perceptimin e ekspertëve në këtë fushë 	Qeveria e Kosovës është anëtarësuar në Projektin e Drejtësisë Botërore. Pjesa më e madhe e treguesve të Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe SKZH në fushën e drejtësisë lidhen me këtë indeks. MD duhet të sigurojë vazhdimin e përfshirjes së Kosovës në këtë indeks/ raport
 Shtylla e katërt – Qeverisja e mirë			
19.	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara me vendet fqinje	Treguesi mat marrëdhëniet e Kosovës me vendet fqinje përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me këto vende	MPJD duhet të vendos një metodologji për definimin e këtij treguesi dhe matjen e rregullt të tij
20.	Numri i misioneve të veçanta të Kosovës në vendet që nuk e kanë njohur atë	Treguesi mat marrëdhëniet e Kosovës me vendet tjera që nuk e kanë njohur Kosovën, përmes hapjes së misioneve të veçanta në to;	MPJD duhet të vendos metodologjinë për matjen dhe raportimin e rregullt të këtij treguesi
21.	Numri i projekteve investuese nga diaspora;	Treguesi mat numrin e projekteve investuese nga diaspora në Kosovë përmes të dhënave nga KIESA	MINT/KIESA duhet të sigurojë grumbullimin e të dhënave sa i përket projekteve

Nr.	Treguesi	Përshkrimi	Veprimet që duhet të ndërmerren
22.	Numri i aktiviteteve të diasporës jashtë vendit me qëllim promovimin e Kosovës;	Treguesi mat angazhimin e Kosovës në mbrojtjen e identitetit dhe gjuhës shqipe të diasporës, përmes numrit të nxënësve nga diaspora të angazhuar në mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës	MPJD duhet të funksionalizojë regjistrin e diasporës dhe të mbledhë të dhëna të vazhdueshme nga misionet diplomatike/qendrat kulturore në vendet tjera për raportimin e këtij treguesi.
23	Kënaqshmëria e qytetarëve jashtë vendit me shërbimet konsullore;	Treguesi mat se në çfarë mase shërbimet diplomatike dhe konsullore mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe interesat e qytetarëve të Kosovës që jetojnë në shtetet përkatëse jashtë Kosovës e cila matet përmes anketës	MPJD duhet të vendos një sistem për matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve jashtë vendit lidhur me shërbimet konsullore
24.	Numri i nxënësve nga diaspora në mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës;	Treguesi mat angazhimin e Kosovës në mbrojtjen e identitetit dhe gjuhës shqipe të diasporës, përmes numrit të nxënësve nga diaspora të angazhuar në mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës	MPJD dhe MASHTI duhet të mbledhin të dhëna për numrin e nxënësve të diasporës të cilët ndjekin mësimet e organizuara të gjuhës amtare.

B. Lista e dokumenteve strategjike që duhet mbajtur dhe zhvilluar

Nr. Sektorët	Fushëveprimi i sektorëve
1 Administrata publike	Planifikimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave publike, shërbimi civil, llogaridhënia, ofrimi i shërbimeve, rregullimi më i mirë, qeverisja elektronike, qeverisja lokale.
2 Financat publike	Financat publike, tregjet financiare, sigurimet, lojërat e fatit, thesari, politikat fiskale, menaxhimi i borxhit, subvencionet për komuna, transferet.
3 Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare	Politika e jashtme dhe diplomacia, bashkëpunimi dypalësh; marrëdhëniet me diasporës, integrimi evropian.
4 Mbrojtja dhe siguria	Mbrojtja, inteligjenca, shërbimi ushtarak, industria ushtarake, mobilizimi, siguria kibernetike, menaxhimi i emergjencave.
5 Siguria publike	Policia, narkotikët, terrorizmi, armët, trafikimi, krimi i organizuar, siguria ushqimore, kontrolli i kufirit, kontrolli i migrimit, refugjatët, azili, siguria kibernetike, siguria e të dhënave personale.
6 Drejtësia	Drejtësia, drejtësia penale, drejtësia civile, drejtësia administrative, mbrojtja e të dhënave personale, e drejta e autorit, drejtësia tranzicionale, krimet e luftës, të drejtat pronësore, dhuna në familje, burgjet, gjykatat, profesionet e lira.
7 Mjedisi	Mbrojtja dhe monitorimi i mjedisit, uji, cilësia e ajrit, menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza, planifikimi hapësinor, zvogëlimi i ndotjes, mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit, hidrometeorologjia.

Nr.	Strategjitë Sektoriale	Programet potenciale për çështje specifike në kuadër të sektorit	Institucioni përgjegjës dhe mbështetës
1	Strategjia për reformën e administratës publike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi për parandalimin dhe reduktimin e barrës administrative; 2. Programi për qeverisje elektronike (aktualisht e planifikuar si strategji); 3. Programi për akomodimin institucional 	MPB/ZKM
2	Strategjia për vetëqeverisje lokale	Programi për zhvillim ekonomik lokal	MAPL
3	Strategjia për reformën e menaxhimit të financave publike		MFPT
4	Strategjia për politikë të jashtme		MPJD
5	Strategjia për diasporë		MPJD
6	Strategjia e mbrojtjes	Plani afatgjatë zhvillimor	MB
7	Strategjia e sigurisë		ZKM/MB/MPB
8	Strategjia për luftimin e krimit të organizuar	Programi kundër trafikimit	MPB
9	Strategjia për menaxhimin e kufirit dhe migrimit	Programi për armët	MPB
10.	Strategjia për sigurinë kibernetike	Programi për infrastrukturën kritike	MPB
11.	Strategjia për menaxhimin e emergjencave		MPB
12.	Strategjia e drejtësisë (aktualisht e miratuar si Strategjia për sundimin e ligjit)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi për të drejtat pronësore 2. Programi për drejtësi tranzicionale (aktualisht duke u zhvilluar si Strategjia për drejtësi tranzicionale) 3. Programi kundër dhunës në familje (aktualisht e miratuar si Strategjia kundër dhunës në familje dhe dhunës mbi baza gjinore) 	MD
13.	Strategjia për Mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm	<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi për efikasitet të energjisë në ndërtesa 2. Programi për cilësinë e ajrit 3. Programi për biodiversitet 	MMPHI
14.	Strategjia për menaxhimin e integruar të mbeturinave		MMPHI
15.	Strategjia për ujërat	Programi për hidrometeorologji	MMPHI

Nr. Sektorët	Fushëveprimi i sektorëve
8 Transporti dhe komunikacioni	Konektiviteti dhe zhvillimi i infrastrukturës së transportit (transporti rrugor; hekurudhor; ajror; multimodaliteti dhe lidhjet), siguria në transport (masat, rregulloret dhe edukimi e sigurisë në transport), mbrojtja e mjedisit në (masat në mjedis, reduktimi i emetimeve, dhe edukimi), digjitalizimi i sistemit të transportit, zhvillon dhe mbështet sektorin postar dhe telekomunikacionit, zhvillon dhe mbështet sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (Infrastruktura brezgjërë, 5G, e-commerce, identifikimit elektronik, sigurisë së sistemeve të informacionit, Inteligjenca Artificiale, Interneti i Gjërave, Të Dhënat e Mëdha, Cloud Computing, Realiteti Virtual, Printimi 3D).
9 Energjia	Zhvillimi i sektorit energjetik (Siguria e furnizimit energjetik, përdorimi i energjisë së pastër, eficienca e energjisë, dekarbonizimi, përballueshmëria për konsumatorët fundor, dhe bashkëpunimi rajonal dhe funksionimi i tregut), Promovimi i sektorin mineral (Zhvillimi i burimeve minerale, zgjerimi dhe modernizimi, mbrojtja e mjedisit)
10 Zhvillimi i industrisë dhe mbështetja për biznese	Mbështetje për Industrinë (Promovimi i eksportit dhe tregtisë, IHD dhe investimet strategjike të diasporës dhe reduktimi i emetimeve në industri), zhvillimi i NMV-ve (aftësitë në ndërmarrësi, diversifikimi i ekonomisë, qasje më e mirë në financa, reduktimi i barrës administrative, standardet e cilësisë dhe siguria e produkteve), mbështetja e ndërmarrësisë tek të rinjtë dhe gratë, mbështetje për inovacion (ekosistem i integruar për inovacion, potencial për inovacion në ndërmarrjet kosovare, zhvillimi i e-biznesit, promovimi i bashkëpunimit me institucionet shkencore); Mbështetje për sektorët strategjikë (zhvillimi i sektorit TIK, zhvillimi i turizmit, zhvillimi i industrisë minerare);
11 Bujqësia	Bujqësia, bujqësia organike, blegtoria, prodhimi dhe mbrojtja e bimëve, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi, përpunimi i ushqimit, ujitja e tokës bujqësore, shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore, mbrojtja dhe rregullimi i tokës bujqësore si dhe zhvillimi rural;
12 Kultura rekreacioni dhe sporti	Artet profesionale, libri dhe botimet, mediat, e drejta e autorit, kultura dhe gjuha, marrëdhëniet me diasporës në kontekst kulturor, religjioni, trashëgimia kulturore materiale dhe shpirtërore; qeverisja në sport, infrastruktura dhe financimi i sportit, sporti konkurrues, aktiviteti fizik dhe rekreacioni i qytetarëve, diplomacia sportive dhe rëndësia sociale e sportit.

Nr.	Strategjitë Sektoriale	Programet potenciale për çështje specifike në kuadër të sektorit	Institucioni përgjegjës dhe mbështetës
16.	Strategjia për transportit multimodal		MMPHI
17.	Strategjia për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit		ME
18.	Strategjia e energjisë	Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë; Plani Kombëtar për Efiçencën e Energjisë	ME
19.	Strategjia për zhvillimin e industrisë dhe mbështetjen e bizneseve	Programi për turizëm; Programi për promovimin e investimeve; Politika tregtare	MINT
20.	Strategjia për ndërmarrësi dhe inovacion		MINT
21.	Strategjia për bujqësi dhe zhvillim rural	Programi për konsolidimin e tokës	MBPZHR
22.	Strategjia për zhvillimin e pylltarisë		MBPZHR
23.	Strategjia për artin, librin dhe kulturën		MKRS
24.	Strategjia për trashëgiminë kulturore		MKRS
25.	Strategjia për sportin		MKRS

Nr. Sektorët	Fushëveprimi i sektorëve
13 Tregu i punës dhe punësimi	Zhvillimi i shërbimeve të punësimit dhe përmirësimi i asistencës për punëkërkuarit, mbështetje këshillëdhënëse dhe udhëzuese, riorientimi profesional dhe përmirësimi i shkathtësive; përputhja e kërkesës dhe ofertës së tregut të punës, vlerësimi dhe parashikimi i nevojave të tregut të punës, bashkëpunimi me institucionet arsimore, zhvillimi i profileve të kompetencave në industri dhe sektorë të ndryshëm; mbështetje për punësimin për grupe specifike të synuara (gratë, të rinjtë, punësimi për personat me aftësi të kufizuara, punësimi i imigrantëve dhe të riadhesuarve); kushtet më të mira të punës dhe dialogu social;
14 Kujdesi social	Mbrotjtja sociale (pensionet, përfitime për shkak të sëmundjeve dhe aftësive të kufizuara, kujdesi për të moshuarit); përfshirja dhe integrimi social, strehimi social, pakicat kombëtare, komunitetet, mbështetje për grupe të veçanta, politikat lidhur me familjen, rininë dhe fëmijët
15 Shëndetësia	Shëndeti publik, infrastruktura, qasja, parandalimi dhe jeta e shëndetshme.
16 Arsimi	Arsimi parashkollor dhe shkollor; arsimi profesional, orientimi profesional dhe mësimi gjatë gjithë jetës; arsimi i lartë, universitetet, kërkimet shkencore; dhe shkathtësitë digjitale në arsim.

Nr.	Strategjitë Sektoriale	Programet potenciale për çështje specifike në kuadër të sektorit	Institucioni përgjegjës dhe mbështetës
26.	Strategjia për punësim dhe treg të punës	1. Programi për sigurinë dhe shëndetin në punë; 2. Programi për Barazi Gjinore	MFPT
27.	Strategjia për mirëqenia dhe mbrojtje sociale		MFPT
28.	Strategjia e shëndetësisë		MSH
29.	Strategjia e arsimit	Programi për shkencë	MASHTI

C. Agjendat horizontale dhe ndërlidhja me dokumentet strategjike

Agjendat Horizontale bazohen në analizën e dokumenteve strategjike ekzistuese dhe ato të propozuara. Qëllimet për sektorët nën secilën agjendë horizontale janë formuluar në SKZH, dhe në strategjitë sektoriale që janë në fuqi dhe ato të cilat pritet të zhvillohen sipas listës në Shtojcën C. Agjenda të tjera horizontale, sikurse zhvillimi rajonal apo specializimi i mençur, mund të zhvillohen sipas prioriteteve të Qeverisë në bazë të kriterëve të përcaktuara në Udhëzuesin për agjendat horizontale. Sipas përkufizimit të agjendave horizontale dokumentet strategjike ekzistuese të cilat janë të natyrës ndërsektoriale kontribuojnë për zbatimin e agjendave horizontale.

1. Agjenda Digjitale për Kosovën

- Strategjia për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit;
- Strategjia e Sigurisë Kibernetike;
- Strategjia për Reformën e Administratës Publike;
- Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike
- Strategjia për Zhvillimin e Kulturës;
- Strategjia e Sportit
- Strategjia për Qeverisje Elektronike
- Strategjia e Transportit Multimodal
- Strategjia për Zhvillimin e Industrisë dhe mbështetjen e bizneseve;
- Strategjia e arsimit
- Strategjia e Shëndetësisë

2. Gjithëpërfshirja

- Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre
- Programi për barazi gjinore
- Programi për të drejtat e njeriut
- Programi për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare
- Strategjia për punësim dhe treg të punës
- Strategjia për mirëqenie dhe mbrojtje sociale
- Personat me të ardhura më të ulëta;
- Strategjia për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara
- Strategjia e migrimit (komponenta e riintegritimit)

3. Agjenda e gjelbër

- Strategjia e energjisë;
- Strategjia për transportin multimodal
- Strategjia për Mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm
- Strategjia për menaxhimin e integruar të mbeturinave
- Strategjia për ujërat
- Strategjia për zhvillimin e industrisë dhe mbështetje për bizneset

4. Migrimi dhe diaspora

- Strategjia për menaxhim të kufirit dhe migrim
- Strategji e diasporës
- Strategjia për punësim dhe tregun e punës
- Strategjia e arsimit
- Strategjia për zhvillimin e industrisë dhe mbështetje për bizneset
- Strategjia për mirëqenie dhe mbrojtje sociale
- Strategjia e kulturës



Strategjia dhe
Plani Kombëtar
për Zhvillim 2030